

**Fakulteti per biznes dhe ekonomi
Menaxhment**



**UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY**

PUNIM DIPLOME MASTER

**NDIKIMI I MARKETINGUT DIGJITAL NË ZHVILLIMIN E
PRODUKTEVE TË REJA TEK KOMPANIA “IPKO”**

Mentori :

Prof. dr. Teuta Veseli Kurtishi

Kandidati :

Festina Ismajli

Tetove ,2021

FALËNDERIME DHE MIRËNJOHJE

Së pari dhe së fundmi falenderoj Zotin për shëndetin e mirë, mirëqenien dhe gjithqka që ishte e nevojshme për të përfunduar studimet e mia.

Realizimi i këtij punimi nuk do të ishte i mundur pa bashkëpunimin e shumë njerëzve

Do të doja të shprehja mirënjohjen time të thellë dhe të sinqertë dhe një falënderim të madh për udhëheqësen time Teuta Kurtishi-Veseli , për udhëheqëjen , durimin, mbështetjen, miqësinë dhe kontributin e saj për arritjen e përfundimit të këtij punimi.

Gjithashtu u jam mirënjohëse të gjithë profesorëve për mbështetjen, bashkëpunimi dhe punën e tyre të pa lodhshme gjatë studimeve dy vjeçare master.

Një falënderim të posatshëm kam edhe për shoqërinë që më kanë dhënë mbështetje në çdo qast.

Në fund dua të falenderoj shumë familjen time për mbështetjen e madhe dhe durimin e tyre në çdo hap të studimeve të mia deri në finalizim

Faleminderit të gjithëve

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Fuqia e Interneti

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1. Gjinia e të anketuarëve

Grafiku 2. Moshë e të anketuarëve

Grafiku 3. Statusi social i të anketuarëve

Grafiku 4. Vendbanimi i të anketuarëve

Grafiku 5. Shkollimi i të anketuarëve

Grafiku 6. Informacionet e produkteve/shërbimeve

Grafiku 7. Vlerësimet e shërbimeve

Grafiku 8. Gjatësia e përdorimit të shërbimeve

Grafiku 9. Vlerësimi i shërbimeve

Grafiku 10. Përdorimi i shërbimeve të kompanisë

Grafiku 11. Mbledhja e informacionit nga konsumatorët

Grafiku 12. Llojet e informacioneve të mbledhura nga klientët

Grafiku 13. Shikimi i programeve televizive online

Grafiku 14. Leximi i të rejave online

Grafiku 15. Posedimi i telefonëve, tabletave apo telefonave të mençur

Grafiku 16. Arsyeja e përdorimit të laptopëve, tabletave dhe telefonave të mençur

Grafiku 17. Koha e përdorimit të laptopëve, tabletave dhe telefonave të mençur

Grafiku 18. Reklamën online

Grafiku 19. Format e mediave

Grafiku 20. Mënyra e blerjes së produkteve/shërbimeve

Grafiku 21. Eksperiencat gjatë blerjes online

Grafiku 22. Ndarja e eksperiencave të konsumatorëve

I. Hyrje

1. Objekti i Hulumtimit

Bota përmes globalizmit po stimulon një ndryshim rrënjësor në mjedisin e marketingut në mënyrën se si organizatat ditët e sotshme po identifikojnë, parashikojnë dhe përmbushin nevojat dhe kërkesat e konsumatorëve të tyre nëpërmjet digjitalizimit. (Jakupi, Scribd, 2009) Identifikimi i nevojave, dëshirave, kërkesave dhe mundësive të klientëve dhe perpjekja për të përmbushur këto pritshmeri është qëllimi i marketingut. Me ndryshimin e mënyrës së jetesës, me avancimin e teknologjisë në përgjithësi, ka lindur edhe nevoja e hartimit të strategjive të reja të marketingut. (Havolli, 2019)

Marketingu digjital i cili po avancohet në mënyrë shumë të shpejtë ka bërë të mundur të reduktohen shpenzimet me rastin e aktiviteteve të marketingut si dhe të menaxhohet në kohë reale promovimi i produktit apo shërbimit. Marketingu digjital ka bërë të mundur thyerjen e barrierave gjeografike, etnike, gjinore, gjuhësore, fetare etj dhe të arrijë tek konsumatorët në çdo kohë, që dikur në kohët e më hershme ishte vetëm një iluzion. (Armstrong, 2014) Marketingu digjital është duke ndryshuar vazhdimisht, duke u avancuar kudo në të gjitha nivelet. (Havolli, 2019). Kjo mund të shihet duke u mbështetur në teknologjinë e informacionit dhe veprimeve agresive të konkurrencës nga të dhënat e mbledhura që do të paraqesim në projekt.

Ky revolucion digjital ka krijuar një epokë informacioni që premtonte të çojë në nivele më të sakta të prodhimit, komunikime më të synuara dhe çmime më relevante dhe konkurruese në treg. (Jakupi, 2010)

Pra marketingu digjital është një formë e drejtëperdrejtë që lidhë konsumatorët me shitësit që përdorin në mënyrë elektronike teknologjitë sic janë : posta elektronike, faqet e internetit, forumet në internet, lajmet, televizioni, komunikimet me telefon, rrjetet sociale etj. (Tracy, 2011)

Ka një të ardhme premtuese për shumë kompani biznesore dhe shumë biznese kanë filluar të përshtatin lëvizjen e tyre drejtë marketingut digjital. Për shkak të ndryshimeve në mjedisin e biznesit, organizatat duhet të jenë në hap me tregun digjital për tu dalluar nga konkurrentët.

Në këtë punim do të bëjme hulumtimin rreth ndikimit të marketingut digjital në kompani. Rast studimi kemi marrë kompaninë IPKO.

Përmes hulumtimit dhe sqarimit të këtijë projekti, shembujve nga praktika dhe të dhënavë, do të paraqesim ndikimin që ka marketingu digjital në zhvillimin e produkteve të reja në kompaninë IPKO.

2. Qëllimet e hulumtimit

Duke parë ndikimin që ka teknologjia në kohët e sotshme dhe numrin e madh të produkteve në treg, është e rëndësishme të hulumtohet se çka e bënë një produkt të ri të futet në treg dhe të jetë i suksesshëm. Qëllimi i këtij punimi është nxjerrja e rezultateve mbi ndikimin e marketingut digjital në plasimin e produkteve të reja në treg. Meqë kam bërë hulumtim për këtë temë, kam parë që kompania "IPKO" e sheh shume të dobishme përdorimin e marketingut digjital për zhvillim të produkteve.

Qëllime të tjera të hulumtimit do të jenë :

- Roli i marketingut digjital në zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve në kompanine Ipko.
- Si te depërtojnë produktet dhe shërbimet e reja në treg me anë të përdorimit të marketingut digjital.
- Si të arrihet 'kapja' e konsumatoreve të rinje me anë të zhvillimit të produkteve të reja.
- Si të arrihet dhe të rritet lojaliteti tek konsumatorët egzistues.
- Si të krijohet zhvillimi i shërbimeve që të jetë i përshtatshëm dhe i arsyeshëm per konsumatorët
- Si të përmirësohet plasimi i shërbimeve të reja në treg.

Gjatë përkufizimit të qëllimeve do të mbështetem në qasjen SMART, që nënkupton së qëllimet do të jenë : specifike, të arritshme, të matshme, reale dhe të definuara në kohë. Në fund të punimit do të paraqitet mënyra se si IPKO investon në marketingun digjital për të hedhur një shërbim të ri në treg, dhe për të ruajtur marrëdhëniet me konsumatorët lojal ekzistues.

Objektivat specifike:

- Të diskutohen të dhënat nga kompania Ipko mbi efektin e marketingut digjital në krijimin dhe lansimin e produktit të ri.
- Të shikohet se si ndërmarrja e ka të zhvilluar planin e marketingut digjital.

3. Hipotezat

H1- Marketingu digjital ndikon pozitivisht në zhvillimin e produkteve të reja tek kompania Ipko.

H2- Mediat sociale përshpejtojnë në zhvillimin dhe futjen në treg të produkteve dhe shërbimeve.

4. Metodologjia e hulumtimit

Për të hulumtuar dhe studiuar këtë problem, do të përdor këto metoda hulumtuese :

Burimet e të dhënave- do të përdor dy lloje të burimeve të të dhënave, ato primare dhe sekondare. Në pjesën e parë të punimit të dhënat janë mbledhur nga burimet sekondare sic janë : literatura e autorëve të ndryshëm, artikuj dhe publikime të ndryshme nëpër revista, në webfaqe, punime shkencore, dhe të dhëna primare që do i mbledh për studimin. Keto të dhëna të mbledhura kanë shërbyer që me anë të metodës së përshkrimit dhe analizës të shqyrtohen dhe të nxirren përfundime në lidhje me efektin e marketingut digjital në zhvillimin e produkteve të reja.

Metodat kërkimore- do të përdor metodën e anketimit. Kjo metodë do të përdoret në pjesën e dytë të punimit ku janë të anketuar 50 klientë të kompanisë Ipko.

Përpunimi i të dhënave- do të bazohet në përdorimin e metodave të ndryshme statistikore sic janë: metodat e analizës, metodat deskriptive- nëpërmjet së cilës janë përshkruar rezultatet e fituata nga pyetjet e pyetësorit, metoda e krahasimit të rezultateve. Për prezantim të rezultateve do të përdor metoda tabelore dhe grafike.

5. Rëndësia e punimit

Në bazë të hulumtimit janë grumbulluar të dhëna, me anë të të cilave do të ndihmojë kompaninë që ka rolin kryesor në këtë tezë, që të ketë një pasqyrim të punës së vet dhe të shohin nga një burim tjetër se sa kane arritur të kapin klientë, përkatësisht se sa mirë përdorin marketingun digjital dhe ku do të mund të përmirësohen. Përmes shembujve të ndryshëm do të dëshmohet që marketingu digjital luan rëndësi të madhe në arritjen e objektivave të kompanisë, që do të thotë se nuk do të ndryshohen koncepte origjinale por vetëm të përshtaten strategjitë dhe metodat më të mira të marketingut ekzistues për të arritur deri tek klientët. Ky punim do të jetë po ashtu një udhërrëfyes i ardhshëm për kompani të reja ose një mjet krahasues me kompanitë e tjera ekzistuese, që nuk e kanë të zhvilluar marketingun digjital. Ka një numër të madh të kompanive në Kosovë që aplikojnë marketingun digjital dhe si rezultat kanë treg të besueshëm. Në disa raste për shkak të ndryshme nuk arrihet një sukses i kënaqshëm i tërheqjes së klienteve. Në këtë punim është sqaruar ndikimi që ka marketingu digjital në zhvillimin e produktit. Cdo organizatë ka planin e vet të marketingut, varësisht nga qëllimet që i kanë, në këtë punim do të paraqesim ndikimin e marketingut digjital në zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve në kompaninë Ipko dhe gjithashtu feedback-un që ka marrë nga marketingu digjital.

6. Strukturimi i punimit

Kapitulli I: Hyrje

- 1.Objekti i hulumtimit
- 2.Qëllimet e hulumtimit
- 3.Hipotezat
- 4.Metodologjia e hulumtimit
- 5.Rëndësia e punimit
- 6.Strukturimi i punimit
- 7.Përfundimi
- 8.Bibliografia

Kapitulli II: Shqyrtimi i literaturës

- 2.1.Marketingu digjital.
- 2.2.Rëndësia e marketingut digjital.
 - 2.2.1. Ndikimi dhe avantazhet e marketingut digjital.
 - 2.2.2. Digjitalizimi dhe menaxhimi i marrëdhënieve me konsumatorë.
 - 2.2.3.Formulimi i strategjisë së marketingut digjital
- 2.2. Roli i produkteve dhe shërbimeve të reja në ekonomi
 - 2.2.1. Procesi i krijimit të produktit ose shërbimit të ri
 - 2.2.2. Qëllimi i lansimit të produkteve ose shërbimeve të reja
 - 2.2.3 Ndikimi i marketingut digjital në zhvillimin e produkteve ose shërbimeve të reja

Kapitulli III: Metodologjia e hulumtimit

- 3.1.Qëllimi i hulumtimit
- 3.2.Instrumentet e hulumtimit
- 3.3.Zgjedhja e mostrës

Kapitulli IV: Analiza dhe komentimi i rezultateve

Kapitulli V: Përfundimi

- 1.Konkluzione dhe rekomandime

7. Përfundimi

Përkushtimi i vëmendjes së ndërmarrjeve të jetë më shumë kah elementet e marketingut digjital. Arritja e nje niveli sa më të lartë të sigurisë për plasimin e produkteve të reja do të kontribuonte drejtperdrejt në rritjen e performancës së ndërmarrjes.

Në këtë studim kemi marrë shumë përgjigje duke u nisur nga ato pozitive që nënkupton përparesitë e aplikimit të elementeve të marketingut gjatë zhvillimit të plasimit të produkteve të reja si dhe mangësitë që kanë disa ndërmarrje nga mosfutja në funksion e marketingut digjital.

Nga rezultatet e marra në fund të këtij projekti do mund të konstatojmë se sa kompania IPKO po i përdor elementet e marketingut për zhvillimin e produkteve të reja, gjë që ishte edhe fokusi i këtij punimi.

8. Bibliografia

Armstrong, P. K. G., 2014. *Google Scholar Articles*. [Online]

Available at:

<https://books.google.com/books?hl=en&lr=&id=UKyaBQAAQBAJ&oi=fnd&pg=PP1&dq=marketing+principles+kotler+scholar+articles&ots=RYncYOO6fx&sig=9WTFBHKqXmLUjzymwZRxHE9VWLg#v=onepage&q&f=false>

Havolli, R., 2019. *Prishtina Press*. [Online]

Available at: <http://prishtinapress.eu/2019/03/27/perdorimi-i-marketingut-digjital-ne-pergjithesi-dhe-rrjeteve-sociale-ne-vecanti/>

Jakupi, A., 2009. *Scribd*. [Online]

Available at: <https://de.scribd.com/doc/13116160/Marketing-Nderkombetare-1>

Jakupi, A., 2010. *Slideshare*. [Online]

Available at: <https://www.slideshare.net/Menaxherat/marketingu>

Tracy, B., 2011. *The art of closing the Sale*. Prishtine: CIP - Biblioteka Kombetare dhe Universitare e Kosoves.

II. Shqyrtimi i literatures

2.1 Marketingu digjital

Duke e pare përdorimin e madh te marketingut dhe zhvillimin e hovshëm të digjitalizimit në këtë punim e kemi hulumtuar dhe kemi paraqitur rëndësinë dhe ndikimin e marketingut digjital në zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja. Nisur nga fakti se marketingu digjital luan një rol shumë të rëndësishëm në shitëblerjen dhe zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve, vlen të theksohet ndikimi që ka në informimin, rikujtimin dhe nxitjen e blerësve në plotësimin e nevojave dhe kërkesave të tyre.

Marketingu digjital është një term për tregtimin e produkteteve dhe shërbimeve cak, të matshme dhe interaktive duke përdorur teknologjinë digjitale për të arritur dhe për të konvertuar ofertën dhe kërkesën deri tek konsumatorët. Objektivi kryesorë është të promovojë markat, të ndërtoj preferenca dhe të rrit shitjet përmes teknikave të ndryshme digjitale. Është i mishëruar nga një selektim i gjerë i taktikave të marketingut të shërbimeve, produkteve dhe markave, të cilat si medium thelbësorë të promovimit kryesisht përdorin internetin. (Ryan & Jones, 2009). Përdorimi i internetit, pajisjeve mobile, mediave sociale, motorëve të kërkimit dhe kanaleve të tjera për të arritur deri tek konsumatorët është marketingu digjital, një përpjekje krejtësisht e re që kërkon një mënyrë të re për t'iu afruar klientëve dhe mënyra të reja për të kuptuar se si sillen klientët në krahasim me marketingun tradicional.(Barone, 2020). Synimi i marketingut digjital është një segment specifik i bazës së klientit dhe është ndërveprues, gjithashtu është në rritje dhe përfshinë reklama të rezultateve të kërkimit, reklama me email dhe promocione, pra është cdo gjë që përfshinë marketingun me reagimet e klientëve ose një ndërveprim të dyanshëm midis kompanisë dhe klientit.(Deiss & Henneberry, 2007)

Marketingu në internet ndryshon nga ai digjital,marketingu në internet është reklamë që është vetëm në internet, ndërsa marketing digjital mund të bëhet përmes pajisjeve mobile, në platforma të ndryshme, në një lojë video, ose përmes një aplikacioni për smartphone.(Barone, 2020).Përdorimi i kanaleve digjitale ka transformuar mënyrën se si tregtarët komunikojnë me konsumatorët e sotëm. Një pjesë e konsiderueshme e konsumatorëve në botë zotërojnë dhe përdorin kompjuter dhe pajisje të lëvizshme, gjë që kontribuon në rritjen e jashtëzakonshme të shpenzimeve të reklamave digjitale. (Chaffey & Chadwick, 2016) .Sipas Chaffey dhe Chadwick marketing digjital mund te përkufizohet si :

“Arritja e objektivave të marketingut përmes aplikimit të teknologjive digjitale dhe mediave”

Marketingu po ndryshon për të përmbushur botën që ndryshon, është dhe mbetet aktiviteti i biznesit që identifikon nevojat dhe dëshirat e klientëve të një organizate, përcakton se cilat tregje të synuara mund të shërbejnë më mirë dhe harton produkte, shërbime dhe programe të përshtatshme për t'i shërbyer këtyre tregjeve. Sidoqoftë, marketingu është shumë më

tepër sesa një funksion i izoluar i biznesit është një filozofi që udhëheq organizatën e tërë. (Havolli, 2019). Qellimi i marketingut është krijimi i kënaqësisë së klientit me fitim duke ndërtuar marrëdhënie të vlerësuara me klientët. Njerëzit e marketingut nuk mund ta përmbushin këtë qëllim vetë. Ata duhet të punojnë thjesht me njerëz të tjerë në kompaninë e tyre dhe me organizata të tjera në zinxhirin e tyre të vlerës, për të siguruar vlera superiore për klientët. Kështu, marketingu i bën thirrje të gjithëve në organizata të 'mendojë klientët' dhe të bëjë gjithçka që mundet për të ndihmuar krijimin dhe ofrimin e vlerës dhe kënaqësisë superiore të klientit. Marketingu nuk është vetëm reklamim ose shitje, marketingu i vërtetë ka të bëjë më pak me shitjen dhe më shumë me të dish se çfarë të bësh. Organizatat fitojnë udhëheqjen e tregut duke kuptuar nevojat e klientëve dhe duke gjetur zgjidhje që kënaqen përmes vlerës, cilësisë dhe shërbimit superior. Asnjë sasi reklamash ose shitje nuk mund të kompensojë mungesën e plotësimin të kërkesave dhe nevojave të klientit. Marketingu ka të bëjë gjithashtu me zbatimin e të njëjtit proces të përmbushjes së nevojave për grupe të tjera përveç konsumatorit përfundimtar. Klientët që paguajnë janë vetëm një grup i palëve të interesuara në shoqërinë tonë, prandaj është e rëndësishme të drejtohem tek të tjerët që ndajnë botën tonë. (Kotler, et al., 1999)

Bota tani është në internet, jashtë të gjithë mjeteve të marketingut modern, kanalet digjitale të marketingut dhe mediat sociale bëhen gjithnjë e më të përfolura, ndërvepruese dhe thelbësore. Çdo fushatë efektive e marketingut do t'i përfshijë strategjitë e marketingut. Marketingu digjital mund të quhet si një qasje, strategji, ose një ushtrim marketingu nga përdorimi i platformave digjitale, siç thot edhe vet emri, strategjia e marketingut digjital është zhvillimi i markës, produktit ose shërbimit në internet, aktualisht marketingu digjital tani është pjesa më e rëndësishme e marketingut mix, është rritur me shpejtësi në vitet e fundit pasi gjithnjë e më shumë bizneset po e kuptojnë rëndësinë e një pranije të mirë të marketingut në kompanitë e tyre. (Mandal & Joshi, 2017). Marketingu ka qenë rreth e rrotull për një kohë e gjatë, prandaj e bizneseve ndiejnë nevojën për të përhapur marketingun, është një nga funksionet më të prekura të biznesit në mënyrë dramatike nga informacioni i dalë i teknologjive. Interneti po u ofron kompanive të reja kanalet e komunikimit dhe bashkëveprimin, ku mund të krijojnë marrëdhëniet më të afërta dhe akoma më efektive me klientët, gjithashtu mund të përdorin internetin për të siguruar në vazhdimësi informacion, shërbim dhe mbështetje, po krijon pozitivitetin ndërveprimi me klientët që mund të shërbejë si themelimi për marrëdhënie afatgjata dhe gjithashtu inkurajon blerjet e përsëritura. (Bala & Verma, 2018). Marketingu digjital e ka ndihmuar këtë epokë në disa mënyra, markat mund të përfitojnë nga marketingu i tyre duke e përdorur atë, po ashtu nuk ka të bëjë vetëm me reklamën, secila kompani mund të reklamojë sa më shumë që dëshiron përmes digjitalizimit, së bashku me këtë mund t'i ofrohen klientëve në mbështetje 24/7 përmes portalit në internet. Përdorimi i këtij ndërveprimi të mediave sociale me marka të ndryshme të marketingut e bën më të lehtë për ata që të marrin reagime pozitive, si dhe negative nga klientët e tyre. Prandaj, këto lloj ndërveprimesh dhe platformash pune kanë revolucionarizuar platformën e bizneseve dhe markave të ndryshme. (Stokes, 2010)

Interneti është mjeti më i fuqishëm në zhvillimin e globalizimit . Eshtë e qartë nga shembujt që kemi dhënë në Tabelën 1. Këto kompani e kanë kuptuar fuqinë e internetit / digjitalizimit që prej shumë kohësh dhe tani ato janë përdoruesit më të mëdhenjtë të internetit.

| <i>Fuqia e Internetit</i> | |
|---|--|
| Banka më e madhe në botë, pa para të gatshme - Bitcoins. |  |
| Kompania më e madhe në botë e Taksive, që nuk zotëron asnjë automjet – UBER |  |
| Pronari më i popullarizuar i botës në media nuk krijon asnjë përmbajtje - Facebook |  |
| Shitësit më i vlefshëm në botë, pa asnjë inventar - amazon, Alibaba.com |  |
| Ofruesi më i madh i akomodimit në botë, që nuk ka pasuri të paluajtshme - airbnb, booking.com |  |

Tabela 1. Fuqia e Interneti (Burim : Research Gate (online))

2.2 Rëndësia e marketingut digjital

Marketingu digjital është një aset i vlefshëm për rritjen e biznesit dhe ndihmon të krijohet një prani autoritare në internet, 89 % e tregtarëve thonë se metodat, si optimizimi i motorëve të kërkimit (SEO), janë të suksesshme. Për më tepër, metodat si reklamimi 'paguaj për klikim' (PPC) rrisin ndërgjegjësimin e markës deri në 80 përqind.(Storm, 2020). Optimizimi i Motorëve të Kërkimit (SEO) synon të tërheqë sasinë më të madhe të qarkullimit të mundshëm në një faqe në internet duke e sjellë atë në krye të rezultateve të kërkimit. Google azhurnon rregullisht algoritmet e tij në mënyrë që të dalin vetëm rezultatet përkatëse. SEO përdoret nga bizneset dhe individët për të maksimizuar dukshmërinë e biznesit ne faqe të internetit dhe për të rritur qarkullimin. Optimizimi i Motorëve të Kërkimit (SEO) është një metodë e përdorur për të vendosur një URL ose faqe në internet në krye të rezultateve të një motor kërkimi. Motorët e kërkimit përdorin fjalë kyçe dhe fraza, algoritme, azhurnime të faqeve në internet dhe strukturën hierarkike të një faqe në internet, dhe qartësinë e gjuhës për të renditur faqet e internetit. Kompanitë shpesh punësojnë specialistë SEO për të zbatuar strategji të tilla për të rritur qarkullimin organik. Qarkullimi organik arrin në një faqe në internet natyrshëm dhe jo si rezultat i përpjekjeve të kërkuesve me pagesë, të tilla si pagesa për klikim (PPC). PPC ose Pay per Click është strategjia me koston më efektive e cila do të sjellë shume qarkullim në biznesin ku aplikohet. (Frankenfield, 2020). PPC qëndron për paguaj-për-klikim, një model i marketingut në internet në të cilin reklamuesit paguajnë një tarifë sa herë që klikohet në një nga reklamatat e tyre. Në thelb, kjo është një mënyrë për të blerë vizita në faqen tuaj, në vend që të përpiqeni të "fitoni" ato vizita në mënyrë organike. Reklamimi i motorëve të kërkimit është një nga format më të njohura të PPC. (Brockbank, 2020)

Ka shume arsye pse marketingu digjital ka rëndësi në suksesin e bizneseve, më poshtë do të përmendim disa nga arsyet : -Arrihen njerëzit atje ku ata kalojnë kohën e tyre-Me rritjen e internetit, më shumë njerëz po kalojnë kohën e tyre në internet, është bërë në tërësi një pjesë e jetës së përditshme për të kryer kërkime, për të kontrolluar mediat sociale, për të blerë produkte në internet etj. Klientët janë në internet, gjë që thekson rëndësinë e marketingut digjital, ata shfletojnë uebin duke kërkuar produktet ose shërbimet që i nevojiten, nëse ata nuk mund t'i gjejnë produktet apo shërbimet që kërkojnë sepse nuk keni një prani në internet, rreziku është humbja e konsumatorëve dhe i çon ata tek konkurrentet. Për të arritur rezultatet më të mira për biznesin , duhet të krijohet prania e secilit biznes në internet ne menyre qe konsumatorët të arrijnë më shumë informacione që dëshirojnë për produktet ose shërbimet. (Galletto, 2016)

Mundësia që të konkurohen korporatat më të mëdha qendron tek marketingu digjital, konkurrenca është pjesa më e vështirë e drejtimit të një biznesi, kur garon në një treg me korporata më të mëdha, si Samsung, Apple, Huawei etj është e vështirë gara me ta, ata kanë një emër të madh për veten e tyre, gjë që tërheq automatikisht njerëzit të besojnë në ato

korporata. Me aplikimin e marketingut digjital është një shans i luftimi kundër korporatave më të mëdha, metodat si SEO dhe reklamimi paguaj për klikim (PPC) nivelojnë fushën e lojës. Marketingu digjital është një mundësi e shkëlqyeshme për biznesin për të konkurruar me kompani më të mëdha dhe për të marrë drejtime më të rëndësishme për biznesin. (Kenton, 2020). Gjithashtu rëndësi të madhe ka edhe kur është për qëllim synimin e audiencës ideale, aftësia për të synuar më mirë audiencën është një nga arsyet më të dukshme për marketingu digjital është i rëndësishëm. Me përdorimin e marketingut digjital, është aftësia për të arritur drejtpërdrejt të interesuarit në biznesin tuaj, nuk duhet të shpresohet se njerëzit do të shohin përjekjet tradicionale të marketingut në kompani dhe do të kontaktojnë biznesin, por përdorimi i marketing digjital nga ana e kompanisë mund të synojë direkt audiencën, më saktësisht sesa me metodat tradicionale të marketingut. Gjithashtu mund të bëhet segmentimi i audiencës p.sh në bazë të gjinise, moshës, vendbanimit etj, kur të synohen mirë konsumatore në audiencë, jepen rezultate më të mira me fushatën. Arrihen më shumë konsumatore që janë të interesuar për produktet ose shërbimet e kompanisë perkatese. (Muhammad, 2018). Strategjitë e marketingut në internet kanë një kthim të jashtëzakonshëm të investimit (ROI). Kthimi i investimit (ROI) është një pjesë e rëndësishme e marketingut digjital (dhe pothuajse e çdo pjesë të marketingut) - kjo tregon nëse po i merrni vlerën e parave nga fushatat e marketingut. Kur të bëhet investimi në këto metoda, do të fitohet më shumë prej tyre. Marketingu me email ka një nga ROI-të më të larta nga të gjitha metodat. Për çdo \$ 1 të shpenzuar, ju keni potencialin për të fituar deri në 44 \$. Është me shumë kosto efektive përdorimi i metodave të marketingut në internet. (Tomita, 2019). Kjo lë hapësirë për një ROI të shkëlqyeshme sepse nuk duhet të shpenzoni shumë para për të drejtuar një fushatë. Nuk kushton shumë për të drejtuar një fushatë PPC ose fushatë reklamuese të mediave sociale, krahasuar me disa metoda tradicionale, të cilat lejojnë që biznesi juaj të ketë një mundësi për tu rritur. (Storm, 2020). Plani i marketingut digjital ndihmon në përcaktimin e objektivave specifike të e-marketingut dhe zhvillimin e strategjive për të siguruar që burimet janë të vendosura për të përfituar nga mundësitë e marketingut të ofruara nga interneti dhe për t'iu kundërvënë kërcënimeve të tij. Marketingu elektronik është i përqendruar në mënyrën se si kompanitë dhe markat e saj përdorin uebin dhe mediat e tjera digjitale të tilla sic janë posta elektronike dhe media mobile për të bashkëvepruar me audiencën saj në mënyrë që të përmbushin qëllimet e saj të marketingut. (Bala & Verma, 2018). Marketingu nuk është vetëm për kompanitë prodhuese, tregtarët me shumicë dhe pakicë, por për të gjitha llojet e individëve dhe organizatave. Të gjithë llojet e bizneseve si avokatët, llogaritarët, mjekët, shitësit etj përdorin marketingun për të menaxhuar kërkesën për shërbimet e tyre. Po kështu edhe spitalet, muzetë dhe grupet e arteve skenike. Asnjë politikan nuk mund të marrë votat e nevojshme dhe asnjë vend turistik nuk mund të fitojë turistë të nevojshëm, pa zhvilluar dhe kryer planet e marketingut. (Kotler, et al., 1999). Marketingu digjital sjell mundësi të reja për kompaninë që të përdorë shumë kanale për marketingun e produkteve dhe shërbimeve të tyre. Media dhe teknologjia digjitale mund të jenë si: medium reklamues, medium me përgjigje të drejtpërdrejtë, platformë për transaksionet e shitjeve, metoda e gjenerimit të produktit, kanali i shpërndarjes, mekanizmi i shërbimit ndaj klientit dhe mediumi për ndërtimin e

marrëdhënieve. Media reklamuese, duke përjashtuar mediat tradicionale, të tilla sic janë gazeta, kanalet në radio, kanalet televizive etj, mund të përdoret në marketing. Kompania mund të shfaqë reklama në faqet e botuesve ose në rrjetet sociale dhe mund të krijojë vetëdije për markat dhe kërkesat për produkte ose shërbime. Medium me përgjigje të drejtpërdrejtë, kompania vendosi prezantimin e produktit ose shërbimit në faqet e botuesve ose rrjeteve sociale. Mund t'u mundësojë klientëve të kërkojnë dhe mësojnë produktin në internet dhe të krahasohen me marka ose kompani të tjera kur konsumatorët tregojnë qëllim për të blerë. (LaMarco, 2019). Platforma për transaksionet e shitjeve, zhvillimi i teknologjisë së informacionit ndryshoi të gjitha aspektet e jetës sonë, blerjet në internet janë bërë një trend. Interneti si një platformë e transaksionit të shitjes sjell komoditet, mallra më të lirë, larmi më të madhe dhe mundësi për të arritur transaksione ndërkufitare. Kanali i shpërndarjes, ofron një kanal për kompaninë që shet mallra direkt tek klientët dhe te shitësit e tjerë në internet. (Fernando, 2020). Mekanizmi i shërbimit ndaj klientit mund të sigurojë një mënyrë që klientët të shërbehën vetë. Për shembull, një institut arsimor në internet mund të vendos video në internet dhe studentët mund të dëgjojnë leksione në shtëpi sipas E-learning. Një shembull tjetër është se klientët mund të bëjnë vetë pyetje shpesh kur kanë lidhje me produktet. Medium për ndërtimin e marrëdhënieve, interneti mund të përdoret si një mjet për të krijuar marrëdhënie me klientët, për t'i kënaqur ata dhe për të rritur besnikërinë e klientëve. Ai përfshin kuptimin më të mirë të nevojës së klientëve, ofrimin e shërbimeve dhe produkteve të mira dhe dërgimin e emailit në mënyrë të rregullt. (Carter, 2019).

2.2.1. Ndikimi dhe avantazhet e marketingut digjital

Një nga ndryshimet më të mëdha në ndërveprimin njerëzor është përhapja e fundit e mediave sociale. Rritja e shpejtë e platformave të bazuara në internet lehtëson sjelljen shoqërore, Interneti ka ndryshuar ndjeshëm natyrën e aktivitetit njerëzor, mjedisit dhe ndërveprimit. Marrëdhëniet reale sociale janë transferuar në botën virtuale, e cila ka çuar në krijimin e komuniteteve në internet, të njerëzve nga e gjithë bota. Kjo lëvizje në dimensionin digjital lejon njerëzit të ndajnë njohuri, të argëtojnë njëri-tjetrin dhe të promovojnë dialogun midis kulturave të ndryshme. Sipërmarrja u krijua dhe u zhvillua në një fazë të vonë të kapitalizmit, kur u veçua si faktori i katërt i prodhimit. Arsyeja për këtë ishte ndërgjegjësimi i ekonomistëve për faktorin vendimtar të sipërmarrjes në përparimin e ekonomisë. Pavarësisht nga një periudhë mjaft e shkurtër kohe, ky faktor i prodhimit, sot, është i popullarizuar dhe po zhvillohet me shpejtësi. Qëllimet e çdo subjekti afarist në planin afatgjatë janë maksimizimi i fitimeve dhe minimizimi i kostos së prodhimit, si dhe plotësimi i nevojave të blerësve. Ndikimi i teknologjise është për shkak të faktit se depërtimi i internetit në të gjitha aspektet e jetës njerëzore ka çuar në një ndryshim në rregullimin tradicional të strukturave të biznesit. Marketingu digjital bazohet në kanalet online me frekuencën më të lartë të përdorimit, ata janë dinamike, ato mund të ndryshojnë nga viti në vitë dhe gjithmonë ndikohen nga trendet e tregut. Me pak fjalë, marketingu digjital vazhdimisht përdor rishikimin, analizën, shpjegimin, procesin e promovimit dhe ndihmon në krijimin e marrëdhënieve më të forta markë-konsumator, duke ndihmuar në identifikimin e mënyrës më efektive të marrëdhënieve të konsumatorit dhe tërheqjen e vëmendjes. Ndikimi i këtij lloji të marketingut jokonvencional ka qenë i madh, duke ndikuar në shitjet dhe numrin e klientëve, duke diktuar, në rastin më të mirë, tendencat tregtare. Nëse shumica e klientëve bashkëveprojnë me mediat sociale, firmat duhet të ndërveprojnë edhe me mediat sociale. Në të kaluarën, tregtarët kanë përdorur postën elektronike, marketingun e drejtpërdrejtë, tregtimin me telefon, faqet e internetit të informacionit, televizionin, radion dhe mekanizmat e tjerë për shpërndarjen e informacionit në lidhje me firmën ose produktet e saj. Rrjeti World Wide Web është përdorur për të paraqitur mesazhe të marketingut përmes pamjeve të faqeve dhe reklamave për të arritur një numër të madh njerëzish në një periudhë të shkurtër kohe. Të jetosh në epokën digjitale, kur të gjithë kanë qasje në internet, është logjike të kalosh në këtë lloj të marketingut dhe përdorimit intensiv të kompanive. (Bizhanova, et al., n.d.)

Marketingu është akti i lidhjes me klientët me një përpjekje për t'i bindur ata drejt blerjes së një produkti ose pajtimit në një shërbim. Marketingu, në çfarëdo forme, është një nga aktivitetet kryesore që duhet të marrë pjesë çdo biznes, pasi asnjë biznes nuk mund të mbijetojë pa marketing efektiv dhe publicitet. Bota është në një epokë digjitale, dhe miliona njerëz kalojnë shumë nga koha e tyre duke u hedhur nëpër platforma digjitale. Bizneset po bëhen gjithnjë e më të vetëdijshëm për këtë fakt dhe prandaj shfrytëzojnë popullaritetin e këtyre platformave për të promovuar mallrat dhe shërbimet e tyre. Marketingu ka të bëjë me lidhjen me klientët në vendin e duhur në kohën e duhur dhe nëse klientët tuaj janë të shumtë në internet, atëherë këtë duhet ta shikojmë në platformat digjitale. Pavarësisht nga lloji i biznesit, qofshin ato një kompani për zhvillimin e aplikacioneve ose një ofrues shërbimesh, përsëri mund të përfitojnë jashtëzakonisht shumë nga pajtimi me shërbimet e

marketingut digjital. Përparësitë e tyre mbi kanalet tradicionale të marketingut janë të mëdha. Më poshtë i kemi renditur disa prej tyre : çmimi i ulët ,kthim i madh i investimit, lehtë për tu matur, lehtë për tu rregulluar, zhvillimi i markes, lehtë për tu ndare, shenjesterimi i sakte, segmentimi , angazhimi i madh etj. Kostoja e marketingut dhe reklamimit është një nga barrat më të mëdha financiare që duhet të mbajnë bizneset. Përderisa bizneset e mëdha mund të mos kenë kaq shumë probleme për të fituar miliona për marketing dhe reklama, për bizneset e vogla, kjo mund të jetë e pamundur ose një makth i padurueshëm. Marketingu përmes platformave digjitale ofron një alternativë më të përballeshme për metodën tradicionale, ato krijojnë më shumë ndikim, por kushtojnë më pak, me vetëm pak para mund të regjistrohemi në një ofrues të marketingut me email dhe të dërgojmë email transaksionar ose të drejtpërdrejtë në mijëra klientë në listën e emaileve. (Ashraf, 2020)

Asgjë nuk ka më shumë rëndësi për një biznes sesa kthimi i investimit që bën, marketingu digjital ofron një kthim të konsiderueshëm të investimeve të vogla, marketingu me email ose drejtimi i fushatave reklamuese në platformat e mediave sociale kushtojnë pak kur krahasohen me teknikat tradicionale të marketingut. (Storm, 2020)

Suksesi ose ndryshe ,një fushatë digjitale lehtë mund të konstatohet , krahasuar me metodat tradicionale ku duhet të presësh javë ose muaj për të vlerësuar vërtetësinë e një fushate, me një fushatë digjitale mund të dish pothuajse menjëherë se si po funksionon një reklamë. Softueri i marketingut me email lejon përdoruesit të gjurmojnë performancën e postave elektronike të tyre,ata mund të dinë sa janë dorëzuar, sa janë lexuar dhe të mësojnë gjithçka rreth normave të tyre të konvertimit. Google Analytics është një mjet shumë efektiv për matjen e qëllimeve specifike që duhet të arrihen në një faqe në internet ose blog, menaxheri i Google AdWords lejon përdoruesit të monitorojnë performancën e reklamave të tyre në kërkimin Google, ata mund të dinë se sa njerëz kanë parë reklamën e tyre dhe të mësojnë gjithçka rreth normave të tyre të konvertimit. (Silverberg, 2020)

Njohja e performancës së një reklame do të informojë një biznes se si të veprojë. Për një fushatë reklamash që po funksionon mirë, është e lehtë të investosh më shumë në të vetëm me një klikim por për një reklamë që nuk po jep siç pritet ajo mund të rregullohet në përputhje me rrethanat ose të ndalet krejtësisht me lehtësi. Në marketingun tradicional, është më e ngurtë pasi një mal i dokumenteve duhet të nënshkruhet dhe në shumicën e rasteve këto marrëveshje janë në baza afatgjata ose afatmesme pra edhe nëse një fushatë nuk po funksionon siç shpresohet, pajtimtarët do të duhet të presin ende skadimin e periudhës së rënë dakord. (Kovalenko, 2020)

Bizneset mund të përdorin platformat e tyre digjitale për të ndërtuar markën dhe reputacionin e kompanisë së tyre. Një uebfaqe e zhvilluar mirë, një blog që përmban artikuj cilësorë dhe të dobishëm, një kanal në media sociale që është shumë interaktiv janë disa nga mënyrat me të cilat një biznes mund të ndërtojë markën e tij. Shumica e kanaleve të marketingut digjital kanë aftësi të ndarjes që lejojnë fushatat dhe artikujt të ndahen me shumë ndjekës. Kjo ndihmon për të krijuar një efekt shumëzues dhe ka aftësinë për të përmirësuar jashtëzakonisht rezultatet e shitjeve. (Gibbons, 2020)

Mjetet tradicionale të marketingut përdorin metodën e spërkatjes dhe lutjes, ku një reklamë përshkon një platformë me shtrirje thelbësore me shpresën që disa njerëz që duan atë që shohin, dëgjojnë ose lexojnë të bëjnë një qasje pozitive,nga ana tjetër, marketingu mbi platformat digjitale lejon fushata të synuara ku reklamën u paraqiten klientëve bazuar në preferencat e tyre ose veprimet fillestare.Platformat e mediave sociale zakonisht kanë një algoritëm shumë të zgjuar që studion dhe përpilon preferencat e përdoruesve. Të tilla që fushatat specifike të reklamave u shfaqen vetëm përdoruesve me një zbulim specifik.

Kjo ndihmon për të rritur gjasat e shitjeve, si dhe për të ulur më tej koston e marketingut.(Muhammad, 2018)

Bota është kthyer në një fshat global, kjo është bërë e mundur përmes digjitalizimit. Marketingu digjital lejon që fushatat reklamuese të jenë të dukshme në çdo pjesë të botës. Kjo u jep bizneseve të vogla fillestare mundësinë e rrallë për t'u bërë global përmes ekspozimit të pamasë. Interneti tegon me bollëk histori fillestare që u bënë jashtëzakonisht të suksesshme gjatë një periudhe të vogël për shkak të mundësive të krijuara falë natyrës globale të marketingut përmes platformave digjitale. (Luenendonk, 2019)

Marketingu jo vetëm që përmes platformave digjitale lejon fushatat të drejtohen ndaj klientëve të veçantë, por gjithashtu lejon segmentimin e klientëve. Segmentimi është procesi në të cilin grupet e mëdha të konsumatorëve ndahen më tej në grupe më të vogla të klientëve sipas një klasifikimi të veçantë. Segmentimi rrit shanset e shitjeve, si dhe ulë koston, për shembull, një dyqan të tregtisë elektronike që ka nisur oferta të reja për veshjet e grave, përdorimi i platformave digjitale, duke ofruar, për shembull, zgjidhje të marketingut me email, lejon biznesin të dërgojë email vetëm tek gratë dhe nëse një ofertë është e disponueshme vetëm në rajone të caktuara, banorët e zonave të dhëna mund të jenë të vetmit që do të marrin emailin. Që segmentimi të funksionojë në mënyrë efektive, informacioni i duhur duhet të mblidhet nga 'subscribers'.(Yesbeck, 2018)

Bota kibernetike po bëhet më e zhurmëshme nga dita në ditë, dhe çdo produkt ose shërbim që ofron nje biznesi ka shumë të ngjarë të ofrohet edhe nga mijëra biznese të tjera. Shkalla mesatare e kërcimit në faqet e internetit është rritur dhe vëmendja e vizitorëve po bie. Kur vizitorët në një faqe në internet nuk gjejnë menjëherë atë që kërkojnë, ata largohen për një alternativë, çelësi për të qëndruar të rëndësishëm dhe për të mbajtur klientët në këtë botë biznesi mjaft konkurruese është të sigurohet angazhim i vazhdueshëm me audiencën e kompanisë. Marketingu efektiv lejon bizneset të qëndrojnë konkurruese dhe të rëndësishme duke u angazhuar me klientët përmes kanaleve të mediave digjitale të ndryshme. Këto platforma lejojnë bizneset t'u përgjigjen pyetjeve të klientëve, të lehtësojnë keqkuptimet dhe madje të gjenerojnë shitje, kjo mund të arrihet përmes postimeve të rregullta të dobishme në blog, gazetave, shfaqjeve, promovimeve dhe ofertave speciale. Ideja është të mbahet vëmendja e klientëve për aq kohë sa të jetë e mundur ndërsa ndërtohet një reputacion i besueshëm.(Oza, 2021)

2.2.2. Digjitalizimi dhe menaxhimi i marrëdhënieve me konsumatorë.

Menaxhimi i marrëdhënieve me klientët (CRM) është kombinimi i praktikave, strategjive dhe teknologjive që kompanitë përdorin për të menaxhuar dhe analizuar ndërveprimet dhe të dhënat e klientit gjatë gjithë ciklit të jetës së klientit. Qëllimi është të përmirësojmë marrëdhëniet e shërbimit ndaj klientit dhe të ndihmojmë në mbajtjen e klientit dhe të nxisim rritjen e shitjeve. Sistemet CRM përpilojnë të dhëna të klientit nëpër kanale të ndryshme, ose pika të kontaktit, midis klientit dhe kompanisë, të cilat mund të përfshijnë faqen e internetit të kompanisë, telefonin, bisedën e drejtpërdrejtë, postën e drejtpërdrejtë, materialet e marketingut dhe rrjetet sociale. Sistemet CRM gjithashtu mund t'u japin anëtarëve të stafit që përballen me klientët informacione të hollësishme mbi informacionin personal të klientëve, historinë e blerjeve, preferencat e blerjeve dhe shqetësimet.(Chai, 2020). Në nivelin më themelor, softueri CRM konsolidon informacionin e klientit dhe e dokumenton atë në një bazë të dhënash të vetme CRM, në mënyrë që përdoruesit e biznesit të kenë më të lehtë qasje dhe menaxhim e tij. Me kalimin e kohës, shumë funksione shtesë janë shtuar në sistemet CRM për t'i bërë ato më të dobishme. Disa nga këto funksione përfshijnë regjistrimin e ndërveprimeve të ndryshme me klientët përmes postës elektronike, telefonit, mediave sociale ose kanaleve të tjera, në varësi të aftësive të sistemit, automatizimi i proceseve të rrjedhës së punës, të tilla si detyrat, kalendarët dhe alarme dhe dhënia e menaxherëve, aftësia për të ndjekur performancën dhe produktivitetin bazuar në informacionin e regjistruar brenda sistemit. (Hargrave, 2020)

Mjetet CRM me aftësi të automatizimit të marketingut mund të automatizojnë detyra të përsëritura për të rritur përpjekjet e marketingut në pika të ndryshme të ciklit të jetës për gjenerimin e udhëheqjes . Për shembull, ndërsa nga perspektivat e shitjeve hyjnë në sistem, ai mund të dërgojë automatikisht përmbajtje të marketingut me email, me qëllimin për ta kthyer një avantazh të shitjeve në një klient të plotë.(Meyers, 2020). Mjetet e automatizimit të forcës së shitjeve ndjekin ndërveprimet e klientëve dhe automatizojnë funksione të caktuara të biznesit të ciklit të shitjeve që janë të nevojshme për të ndjekur drejtimet, për të marrë klientë të rinj dhe për të ndërtuar besnikërinë e klientit.(White, 2018). Krijuar për të zvogëluar aspektet e lodhshme të punës së agjentit të qendrës së kontaktit, automatizimi i qendrës së kontaktit mund të përfshijë një audio të para-regjistruar që ndihmon në zgjidhjen e problemeve të konsumatorëve dhe shpërndarjen e informacionit. Mjete të ndryshme softuerësh që integrohen me mjetet desktop të agjentit mund të trajtojnë kërkesat e klientëve në mënyrë që të shkurtojnë kohëzgjatjen e thirrjeve dhe të thjeshtojnë proceset e shërbimit ndaj klientit. Mjetet e automatizuara të qendrës së kontaktit, të tilla si chat-robot, mund të përmirësojnë përvojat e përdoruesit të klientit.(Grech, 2019). Disa sisteme CRM përfshijnë teknologji që mund të krijojnë fushata gjeografike të marketingut bazuar në vendndodhjet fizike të klientëve, ndonjëherë duke u integruar me aplikacionet e njohura të bazuara në vendndodhje (sistemi global i pozicionimit). Teknologjia e vendndodhjeve mund të përdoret po ashtu si një mjet i menaxhimit të rrjeteve ose kontakteve në mënyrë që të gjenden perspektivat e shitjeve bazuar në një vendndodhje.(Goodrich, 2020). Sistemet CRM ndihmojnë bizneset të optimizojnë proceset duke ristrukturuar ngarkesat e rëndomta të punës, duke u mundësuar punonjësve të përqendrohen në detyra krijuese dhe më të nivelit të lartë.Udhëzimet e shitjeve mund të gjurmohen përmes CRM, duke u mundësuar skuadrave të shitjeve të fusin,

gjurmojnë dhe analizojnë të dhëna për udhëheqje në një vend.(Johnson, 2017). Sistemet CRM ndihmojnë në gjurmimin e informacionit të punonjësve, të tilla si informacionet e kontaktit, rishikimet e performancës dhe përfitimet brenda një kompanie. Kjo i mundëson departamentit të BNJ-së që të menaxhojë në mënyrë më efektive fuqinë e brendshme të punës. (Meyers, 2020)

Analizat në CRM ndihmojnë në krijimin e niveleve më të mira të kënaqësisë së klientit duke analizuar të dhënat e përdoruesit dhe duke ndihmuar në krijimin e fushatave të synuara të marketingut. Teknologjitë e inteligjences artificiale, të tilla si Salesforce Einstein, janë ndërtuar në platformat CRM për të automatizuar detyrat e përsëritura, për të identifikuar modelet e blerjes së klientëve për të parashikuar sjelljet e klientëve në të ardhmen dhe më shumë. Disa sisteme CRM përfshijnë veçori për të ndihmuar përdoruesit të mbajnë gjurmët e detajeve të projektit të klientit siç janë objektivat, shtrirja strategjike, proceset, menaxhimi i rrezikut dhe progresi. Shumë sisteme CRM mund të integrohen me programe të tjerë, të tilla si sistemet e qendrës së thirrjeve dhe planifikimit të burimeve të ndërmarrjeve (ERP).(Bhardwaj, 2019). Tradicionalisht, praktikat e marrjes së të dhënave për sistemet CRM kanë qenë përgjegjësi e departamenteve të shitjeve dhe marketingut, si dhe agjentëve të qendrave të kontaktit. Ekipet e shitjeve dhe marketingut sigurojnë udhëheqës dhe azhurnojnë sistemin me informacion gjatë gjithë ciklit të jetës së klientit dhe qendrat e kontaktit mbledhin të dhëna dhe rishikojnë të dhënat e historisë së klientit përmes thirrjeve të shërbimit dhe ndërveprimeve të mbështetjes teknike.(Hollar, 2015). Mediat sociale në CRM përfshijnë biznese që angazhohen me klientë direkt përmes platformave të mediave sociale, të tilla si Facebook, Twitter dhe LinkedIn. Mediat sociale paraqesin një forum të hapur për klientët për të ndarë përvojat me një markë, pavarësisht nëse ata transmetojnë ankesa apo promovojnë produkte. Për t'i shtuar vlerë ndërveprimeve të klientëve në mediat sociale, bizneset përdorin mjete të ndryshme CRM sociale që monitorojnë bisedat në media sociale - nga përmendjet specifike të një marke deri te frekuenca e fjalëve kyçe të përdorura - për të përcaktuar audiencën e tyre të synuar dhe cilat platforma përdorin

Mjete të tjera janë krijuar për të analizuar reagimet e mediave sociale dhe për të adresuar pyetjet dhe çështjet e klientëve. Kompanitë janë të interesuara në kapjen e mendimeve të klientëve, të tilla si gjasat që ata do të rekomandojnë produktet dhe kënaqësinë e tyre të përgjithshme për klientët, për të zhvilluar strategji të marketingut dhe shërbimit. Kompanitë përpiqen të integrojnë të dhënat sociale CRM me të dhëna të tjera të konsumatorëve të marra nga departamentet e shitjeve ose marketingut për të marrë një pamje të vetme të klientit. Një mënyrë tjetër në të cilën CRM social shton vlerë për kompanitë dhe klientët është përmes komuniteteve të klientëve, ku klientët postojnë rishikime të produkteve dhe mund të angazhohen me klientë të tjerë për të zgjidhur probleme ose për të hulumtuar produkte në kohë reale. Komunitetet e klientëve mund të ofrojnë shërbim të ulët për klientët për lloje të caktuara të problemeve dhe të zvogëlojnë numrin e thirrjeve të qendrave të kontaktit. Komunitetet e klientëve gjithashtu mund të ofrojnë ide të reja të produkteve ose reagime që kompanitë mund të përdorin në vend të grupeve të feedback-ut.(Hoyos, 2011). Aplikacionet CRM të ndërtuara për smartphone dhe tabletë janë bërë një gjë e domosdoshme për përfaqësuesit e shitjeve dhe profesionistët e marketingut të cilët dëshirojnë të kenë akses në informacionin e klientit dhe të kryejnë detyra kur nuk ndodhen fizikisht në zyrat e tyre.

Aplikacionet CRM për celularët përfitojnë nga veçoritë që janë unike për pajisjet mobile, të tilla si GPS dhe aftësitë e njohjes së zërit, për t'i dhënë punonjësve të shitjeve dhe

marketingut akses në informacionin e klientit nga kudo vjetër. (MacDolnald, 2021)
Një sistem CRM në një mjedis B2B ndihmon në monitorimin e shitjeve ndërsa lëvizin nëpër hinkën e shitjeve, duke i mundësuar një biznesi të adresojë çdo çështje që mund të dalë gjatë procesit. Sistemet CRM në tregun B2B ndihmojnë në krijimin e më shumë dukshmërisë në linja dhe, për këtë arsye, rrisin efikasitetin gjatë gjithë procesit të shitjes.(Rouse, 2020)

2.2.3. Formulimi i strategjisë së marketingut digjital

Ku i merrni informacionet për produktet/shërbimet e Ipko-s?


Nga gjithësej 50 e të anketuarëve, këto rezultate i kemi në pyetjen e parë të anketës, tek pyetja : Ku i merrni informacionet për produktet / shërbimet e ofruara nga Ipko, të anketuarit u përgjigjën si më poshtë: 10 prej tyre u përgjigjën se marrin informacion nga kompania, 5 prej tyre nga familja, 21 prej tyre nga reklamat, askush nga të anketuarit nuk merr informacion nga gazeta, dhe 14 prej tyre nga burime të tjera.



Grafiku 6. Informacionet e produkteve/shërbimeve

A jeni të kënaqur me shërbimet e kompanisë Ipko ?


Në pyetjen tjetër nëse konsumatorët janë të kënaqur me shërbimet e ndërmarrjes Ipko, rezultatet ishin si më poshtë: 30 ishin shumë të kënaqur, 10 prej tyre ishin të kënaqur, 8 prej tyre ishin neutral dhe 2 prej tyre ishin të pakënaqur. Nga rezultatet mund të kuptojmë se shumica e klientëve janë shumë të kënaqur me shërbimet e ofruara nga kompania, dhe nuk kishte asnjë klient që ishte shumë i pakënaqur.



Grafiku 7. Vlerësimet e shërbimeve

Sa gjatë i keni përdorur shërbimet tona ?


Në pyetjen e rradhës se sa gjatë i kanë përdorur konsumatorët produktet dhe shërbimet e kompanisë kemi marrë këto rezultate : nuk kishte asnjë konsumatorë që i përdore shërbimet më pak se një muaj, kjo për arsye se kompania ipko në të shumten e kohës ofron oferta mujorëshe për konsumatorët si pakot mobile dhe interneti në shtëpi, rezultatet tjera ishin këto : 2 konsumatorë perdornin 1-6 muaj gjatë shërbimet, 13 konsumatorë përdorin 6 muaj-1 vitë shërbimet, 10 konsumatorë përdorin shërbimet 1-2 vite dhe 25 konsumatorë i përdorin shërbimet e kompanisë 2 e më shumë vite. Nga ky rezultat mund të kuptojmë se shumë konsumatorë janë lojal në përdorimin e shërbimeve të kompanisë ipko.



Grafiku 8. Gjatësia e përdorimit të shërbimeve

Krahasuar me shërbimet që i ofrojnë konkurrentët tjerë, çfarë vlerësimi keni për shërbimet tona ?

Nga rezultati i marrë në pyetjen se çfarë vlerësimi kanë konsumatorët për shërbimet tona në krahasim me shërbimet e ofruara nga konkurrentët kemi rezultatet e mëposhtme: 16 prej tyre u përgjigjën se shërbimet e kompanisë janë shumë të mira, 20 prej tyre u përgjigjën se shërbimet janë të mira, 10 prej tyre u përgjigjën se shërbimet e ipko janë të njëjta me kompanitë e tjera konkurruese, ndërsa 4 prej tyre u përgjigjën se shërbimet e ipko janë më të këqija krahasuar me shërbimet e ofruara nga




konkurrentët.

Grafiku9. Vlerësimi i shërbimeve

A do ti përdorni apo bleni shërbimet e kompanisë Ipko përsëri ?


Nga të gjithë të anketuarit ,në pyetjen nëse do të përdorni ose blini përsëri shërbimet e kompanisë ipko, ne kemi marrë rezultatet e më poshtme: 15 prej tyre u përgjigjën se do të përdorin definitivisht shërbimet, 11 prej tyre u përgjigjën se me siguri do të përdorin shërbimet të kompanisë, 18 prej tyre u përgjigjën se ata ndoshta do t'i përdorin ato ndoshta jo, 4 prej tyre u përgjigjën me siguri jo, dhe vetëm 2 prej tyre u përgjigjën se nuk do të përdorin / blejnë shërbimet e ipko. Nga ky rezultat mund të kuptojmë se shumica e konsumatorëve do të përdorin / blejnë shërbimet e ipko.



Grafiku 10.Përdorimi i shërbimeve të kompanisë

A mbledh informacione për një shërbim/produkt përpara se ta blini ?


Nga rezultatet e marra nga pyetja nëse konsumatorët mbledhin informacion në lidhje me një shërbim / produkt përpara se ta blejnë atë, kemi këto rezultate: 40 konsumatorë u përgjigjën me PO ndërsa 10 me JO, nga rezultatet mund të kuptojmë se një numër i madh i konsumatorëve hulumtojnë më parë për të blerë një produkt ose shërbim.



Grafiku 11.Mbledhja e informacionit nga konsumatorët

Nëse PO, çfarë lloje të informacioneve mlihdni ?


Nga rezultatet e marra në pyetjen se çfarë lloj informacioni mbledhin konsumatorët para se të bëjnë një blerje të shërbimeve, ne mund të kuptojmë se konsumatorët përqendrohen më shumë në sasinë dhe çmimin e shërbimit dhe kemi rezultatet e mëposhtme: 18 të konsumatorëve mbledhin informacion mbi sasinë, 10 prej tyre mbledhin informacion mbi çmimin, 8 prej tyre mbledhin informacion në lidhje me cilësinë, 6 prej tyre mbledhin informacion në lidhje me tiparet, dhe 8 prej tyre në lidhje me përvojat e klientit.



Grafiku 12. Llojet e informacioneve të mbledhura nga klientët

A shikoni programe televizive online ?


Nga 50 e të anketuarëve përgjigjet e pyetjes se a shikojnë programe televizive në internet ishin këto, 45 nga të anketuarit u përgjigjën me PO- shikojnë programe televizive në internet ndërsa 5 u përgjigjën JO- nuk shikojnë programe televizive në internet. Nga ky rezultat mund të kuptojmë se një numër me i madh i konsumatorëve shikojnë programe televizive në internet.



Gragiku 13. Shikimi i programeve televizive online

A i lexoni të rejat online ?


Nga rezultatet e pyetjes nëse konsumatorët lexojnë lajme të reja në internet i kemi këto përgjigje, 35 nga të anketuarit u përgjigjën me PO, 5 nga të anketuarit u përgjigjën JO dhe 10 nga të anketuarit u përgjigjën Ndonjëherë, nga ky rezultat mund të kuptojmë se një numër i konsiderueshëm i konsumatorëve lexojnë lajmet në internet ku ata gjithashtu marrin informacione të ndryshme.



Grafiku 14. Leximi i të rejave online

A keni laptop, tablet apo telefon të mençur ?


Nga gjithësej 50 të anketuarit, në pyetjen se a kanë laptop, tablet apo telefon të mençur nëse, të gjithë konsumatorët u përgjigjën se ata kanë një laptop, tablet ose smartphone. Asnjë prej tyre nuk u përgjigj me JO, nga ky rezultat mund të kuptojmë se një ditë e sotme pothuajse secili individ zotëron pajisje elektronike për të kycur në to siç janë laptopët, tabletët, smartphone-t etj.



Grafiku 15. A kanë konsumatorët laptop, tablet apo telefon të mençur.

Për çfarë i përdorni këto vegla ?


Kur u pyetën se për çfarë i përdorin këto mjete (laptopë, tableta dhe telefona të menqur) të anketuarit u përgjigjën si më poshtë: 5 prej të anketuarve u përgjigjën se i përdorin pajisjet vetëm për lojëra, 4 prej tyre u përgjigjën se i përdorin ato për shfletim në internet, 12 prej tyre u përgjigjën se i përdorin për blerje në internet, 2 prej tyre u përgjigjën se i përdorin për të parë lajmet, 18 prej tyre u përgjigjën se i përdorin për rrjete sociale, 1 prej tyre u përgjigj se e përdor për lexim online, 3 prej tyre u përgjigjën ata i përdorin ato për të parë video, 5 prej tyre u përgjigjën se i përdorin për 'bisedë'. Nga rezultati mund të kuptojmë se një numër i madh i konsumatorëve i përdorin këto mjete për shfletimin e rrjeteve sociale dhe blerjet në internet.



Grafiku 16. Arsyeja e përdorimit të llatopëve, tabletëve dhe telefonave të menqur.

Kur i përdorni këto vegla?


Nga rezultatet e pyetjes se kur i përdorin këto mjete, të anketuarit u përgjigjën si më poshtë: 6 prej tyre u përgjigjën se i përdorin gjatë shikimit të TV, 5 prej tyre u përgjigjën se i përdorin ato ndërsa janë në zyrë, 5 prej tyre u përgjigjën se ata i përdorin ato ndërsa shikojnë në shkollë, 10 prej tyre u përgjigjën se i përdorin ndërsa janë me shokë, 14 prej tyre u përgjigjën se i përdorin në kohën e tyre të lirë, dhe 10 prej tyre u përgjigjën se i përdorin gjatë orarit të punës / shkollës . Nga rezultatet mund të kuptojmë se një numër i madh i konsumatorëve përdorin laptopë, tableta dhe telefona inteligjentë më shumë në kohën e tyre të lirë.



Grafiku 17. Koha e përdorimit të llatopëve ,tabletëve dhe telefonave të menqur.

A i keni vënë re reklamat online të kompanisë gjatë shfletimit?


Kur u pyetën nëse konsumatorët vërejnë reklama e kompanisë në internet gjatë shfletimit, ne kemi marrë këto rezultate, 18 prej tyre u përgjigjën PO, 12 prej tyre përgjigjën JO dhe 20 prej tyre përgjigjën Ndonjëherë. Nga këto rezultate mund të kuptojmë që reklamimi në internet ka një ndikim tek konsumatorët, ata shohin dhe klikojnë për të parë më shumë mbi ta.



Grafiku 18. Reklamat online

Nëse po, përmend njëren nga format e mediave nga lista, cilës i jepni më shumë rëndësi në reklamë?


Kur u pyetën se cila formë e mediave u japin më shumë rëndësi konsumatorëve, ata u përgjigjën si më poshtë: 10 prej tyre u përgjigjën se i japin më shumë rëndësi formës së medias në TV, 30 prej tyre u përgjigjën se i japin më shumë rëndësi formës së mediave Online, asnjëri prej tyre nuk u përgjigj se i japin rëndësi gazetës, 3 prej tyre u përgjigjën se i japin rëndësi Youtube, dhe 7 prej tyre u përgjigjën se i japin rëndësi radios. Nga rezultatet e marra mund të kuptojmë se një numër i madh i konsumatorëve i kushtojnë më shumë vëmendje formës së mediave online.



Grafiku 19. Format e mediave

Si e bleni një produkt/shërbim prej kompanisë Ipko ?


Kur u pyetën se si konsumatorët e blejnë produktin / shërbimin nga kompania, ata u përgjigjën si më poshtë: 10 prej tyre hulumtojnë në telefon përpara se të blejnë produktin / shërbimin, më pas e blejnë atë në pikën e shitjes, 6 prej tyre u përgjigjën se së pari kërkojnë nga laptopi më pas e blejnë atë në pikën e shitjes, 20 prej tyre u përgjigjën se ata bëjnë kërkimin dhe blejnë produktin / shërbimin përmes telefonit, 4 prej tyre u përgjigjën se do të hulumtojnë dhe do të blejnë përmes laptopit, ndërsa pjesa tjetër e 10 personave u përgjigj se ata do të vizitojnë pikat shitëse dhe do të bëjnë blerje të produkteve ose shërbimeve. Nga rezultatet e marra mund të kuptojmë se një numër i madh i konsumatorëve hulumtojnë dhe blejnë përmes telefonit.



Grafiku 20. Mënyra e blerjes së produkteve/shërbimeve

Pas blerjes, qfarë lloje eksperiencash i ndani me të tjerët?


Kur u pyetën se cilat lloje të përvojave konsumatorët ndajnë me të tjerët pas blerjes, ne morëm rezultatet e mëposhtme: 2 prej tyre u përgjigjën se ndajnë përvoja me çmime, qofshin të mira apo të këqija, 4 prej tyre u përgjigjën se ndajnë vetëm përvoja të këqija mbi produktet, 4 prej tyre u përgjigjën se ndajnë vetëm përvoja të mira mbi produktet, ndërsa 40 prej tyre u përgjigjën se ndajnë të gjitha përvojat e blerjes.



Grafiku 21. Eksperiencat gjatë blerjes

Si do ti ndanit eksperiencat me të tjerët ?

Në pyetjen e fundit, si do t'i ndani përvojat tuaja me të tjerët, ne kemi rezultatet e mëposhtme: 20 prej tyre u përgjigjën se i ndajnë ato në rrjetet sociale, 5 prej tyre u përgjigjën se i ndajnë ato përmes mesazheve, 15 prej tyre u përgjigjën se i ndajnë ato në faqen e internetit të kompanisë, dhe 10 prej tyre u përgjigjën se i ndajnë ftyrë për ftyrë . Nga këto rezultate mund të kuptojmë se një numër më i madh i konsumatorëve ndajnë përvojat e tyre në rrjetet sociale



Grafiku 22.Ndarja e ekperiencave të konsumatorëve

Bazuar në rezultatet e fituara në këtë pjesë hulumtimi e cila është zhvilluar me metodat kualitative dhe kuantitative kemi arritur në rezultat se teknologjia digjitale në kohet e fundit është shumë i zhvilluar dhe gjithnjë e më shumë ka rritje të vazhdueshme, konsumatorët janë ata që e përdorin teknologjinë më shumë për të arritur deri tek kërkesat e tyre mbi produktet apo shërbimet andaj secila kompani që ofron shitje të cfarëdo produkti apo shërbimi duhet të këtë të zhvilluar marketingun digjital në mënyre që të ketë mundësi të takojë kërkesën e konsumatorit me ofertën. Kompania për të cilën kemi bërë hulumtimin ka të zhvilluar marketingun digjital dhe ofron mundësi për konsumatorët e tyre që të kenë qasje të lehtë deri tek shërbimet që ofron kompania. Roli i marketingut digjital dhe ndikimi që ka në përshpejtimin dhe futjen e produkteve/shërbimeve të reja ne treg i mundeson kompanisë loko që të ketë një qasje më të lehtë me konsumatorët e tyre.

Kapitulli V: Përfundimi

Konkluzione

Bazuar në të gjeturat ,rezultatet e fituara nga anketimi i konsumatorëve të kompanisë Ipko, por edhe nga literatura e shqyrtuar kam arritur në përfundim që kompania e studiuar por edhe kompanitë e tjera që operojnë në këtë lami nëse dëshirojnë të mbijetojnë në tregun superdinamik me konkurrencë të pamëshirshme, duhet patjetër të plotësojnë më shpejtë se konkurrenca e tyre dëshirat dhe nevojat e konsumatorëve në mënyrë që të përfitojnë konsumatorë lojalë, dhe duke pasur parasysh zhvillimin e hovshëm teknologjik, qëndrimi sa më afër këtyre nevojave dhe dëshirave të konsumatorëve është i mundur vetëm nëpërmjet marketingut digjital. Përkushtimi i vëmëndjes së ndërmarrjeve më shumë kah elementet e marketingut dhe arritja e një niveli sa më të lartë të sigurisë për plasimin e produkteve të reja do të kontribuonte drejtëpërdrejt në rritjen e performancës së ndërmarrjes. Ky studim na ka dhënë shumë përgjigjeje, duke u nisur nga ato pozitive që nënkupton përparësitë e aplikimit të elementeve të marketingut gjatë zhvillimit dhe plasimit të produkteve të reja si dhe mangësitë që kanë disa ndërmarrje nga mos futja në funksion e këtyre elementeve.

Nga rezultatet e nxjerra nga intervista e zhvilluar me menaxheren e kompanisë Ipko Iliriana Krasniqi, mund të konstatohet se në përgjithësi kompania po i përdorë mjaftë elementet e marketingut dhe ka të zhvilluar departamentin e marketingut i cili ndikon në zhvillimin e produkteve/shërbimeve të reja dhe mbanë konsumatorët të informuar për produktet/shërbimet aktuale gjë që ishte fokus i këtij studimi dhe kjo e vërteton **Hipotezën 1**- “Marketingu digjital ndikon pozitivisht në zhvillimin e produkteve të reja tek kompania Ipko”. Elementet e marketingut kanë ndikim në uljen e rreziqeve gjatë planifikimit të produktit të ri dhe zhvillimit të tyre deri të konsumatori i fundit. Shumë ndërmarrjet e kanë kuptuar se ato egzistojnë në treg për t’i plotësuar kërkesat e konsumatorëve pak më mirë apo shumë më mirë se konkurrenca, në të kundërtën, nëse nuk egziston kërkesa për ato produkte,ndërmarrjet edhe do ishin shuar fare.

Në epokën e internetit ,botën e re të marketingut ,konsumatorët janë të mbushur nga reklama dhe informacione të ndryshme ,siç është potencuar në literaturë dhe po ashtu në anketën që e kemi zhvilluar me 50 të anketuar kemi arritur të kuptojmë se nëse produkti apo shërbimi i një kompanie nuk kënaq pritshmëritë e konsumatorit ,ajo do të përhapet shumë shpejt tek të gjithë konsumatorët brenda minutës, kjo po u lehtëson zgjedhjen konsumatorëve që janë në dilemë mes produkteve/shërbimeve të shumëta në treg , por po u ndihmon edhe kompanive që të përmirësojnë produktet dhe shërbimet e tyre, duke kuptuar shpejt për dobësitë e tyre, pra mediat sociale përshpejtojnë futjen je treg te produkteve/shërbimeve dhe kjo e vërteton **Hipotezë 2** -“ Mediat sociale përshpejtojnë në zhvillimin dhe futjen në treg të produkteve dhe shërbimeve”andaj ,kompania Ipko duhet të inkurajojnë konsumatorët e tyre që të lënë feedback pas përdorimit të shërbimeve që ata ofrojnë, nëse dëshirojnë të shtrijnë rrjetin e tyre edhe më gjerë

Sjellja e konsumatorëve është e ndryshme nga njëri konsumator tek tjetri prandaj, në literaturë u shqyrtua çështja e lojaliteti të konsumatorëve. Ka ende konsumatorë të cilët janë verbërisht lojalë ndaj markës që të lënë përshtypje se janë të izoluar nga bota duke zgjedhur produktin apo shërbimin e kompanisë pa vlerësuar fare alternativat e tjera, por numri i tyre është në rënie të vazhdueshme, kjo për arsye se efekti i marketingut digjital ndikoi që përqendrimi i vëmendjes së konsumatorëve të jetë shumë më i shkurtër. Këto ndryshime të konsumatorëve modernë tregojnë se kompanitë duhet të hartojnë dhe tu japin konsumatorëve programe kreative si dhe aplikacione që do t'i mbanin konsumatorët vazhdimisht të informuar për kompanitë pa pasur nevojë të shkojnë në sportele për t'u informuar duke i lehtësuar punën vetës dhe duke e kursyer kohën konsumatorëve. Kështu krijohen marrëdhënie më të ngrohta me konsumatorët ekzistues dhe krijohen mundësi më të mëdha për të përfituar konsumatorë të rinj. Bazuar në rezultatet e dala, është vërtetuar se zhvillimi teknologjik ka ndikuar që konsumatorët e kompanisë lloko të kuptojnë më lehtë rreth më të reja në kompani ,prandaj kompania duhet të ofrojë shërbime më inovative dhe shërbime më të shpejta. Për të qenë konkurrent në treg ndërmarrjet duhet të zbulojnë pse konsumatori blen produktin e caktuar, cilat janë teknikat dhe qasja ndaj konsumatorit, duke u bazuar në atë që është thënë shumë herë se “konsumatori është mbret” ai në fund e blen produktin dhe i siguron të ardhura ndërmarrjes Plasimi dhe zhvillimi i produkteve të reja nga ana e ndërmarrjes konsiderohet si hap mjaft i rëndësishëm, po aq rëndësi ka edhe për ekonominë e një vendi në përgjithësi, duke ditur se çdo zhvillim kërkon angazhim shtesë, edhe zhvillimi i produkteve të reja kërkon angazhim shtesë të fuqisë punëtore që rrjedhimisht, plasimi i produkteve të reja në treg ndikon edhe në mirëqënien e një vendi duke krijuar vende të reja të punës.(Barkman, 2018).

Rekomandime

Ndërmarrjet duhet të vlersojnë përparësitë, të njohin dhe përmirësojnë dobësitë, identifikojnë mundësitë që mund t'i shfrytëzojnë për zhvillimin e ndërmarrje si dhe uljen e rreziqeve duke aplikuar të gjitha elementet e nevojshme të marketingut sa i përket produkteve dhe shërbimeve të reja. Ndërmarrjet duhet të vlersojnë nevojat e tregut dhe të konsumatorëve duke tentuar të kuptojnë se çfarë dëshiron konsumatori/ tregu dhe jo të tentojnë të "nënkuptojnë", para se të lansojnë një produkt të ri.Ndërmarrjet të cilat lansojnë një produkt të ri në treg duhet të jenë të kujdesshme në përzgjedhjen e strategjisë së caktimit të çmimit, pra përaktimi i çmimit duhet të jetë në harmoni me llojin e produkti që ndërmarrja vëndos ta lansoj. Duke u bazuar në të dhënat nga hulumtimi pamë se si shkak i mospërzgjedhjes së strategjisë më të mirë të caktimit të çmimit ka pasur raste që produkti edhe ka dështuar plotësisht Në periudhën e ardhshme kompanitë në përgjithësi duhet të mbeshteten më tepër në hulumtimin e tregjeve sa i përket produkteve apo shërbimeve të reja si dhe duhet të vazhdojnë me aplikimin e formave te marketingut të tilla si reklama dhe marketing te ndryshëm.

Bibliografia

1. Anil Menon, S. B. P. T. A. S. E., 2014. *Effective Marketing Strategy-Making: Antecedents and Consequences*. s.l.:s.n.
2. Anon., a.d. *Marketing Planing* \6. s.l.:s.n.
3. asdre.ru, 2019. *asde.ru*. [Në linjë]
Available at: <https://asde.ru/sq/consumer-protection/stages-of-creating-a-new-product-the-basic-stages-of-developing-a-new-product/>
[Qasja 30 April 2019].
4. Ashraf, S., 2020. *Muzawed*. [Në linjë]
Available at: <https://muzawed.com/en/advantages-and-disadvantages-of-digital-marketing/>
[Qasja 2020].
5. Attiah, E., 2019. *The Role of Manufacturing and Service Sectors in Economic*, s.l.: European Research Studies Journal.
6. Bala, M. & Verma, D., 2018. *Researchgate.net*. [Në linjë]
Available at:
https://www.researchgate.net/publication/328253026_A_Critical_Review_of_Digital_Marketing
[Qasja October 10 2018].
7. Barkman, A. N., 2018. *Tech Funnel*. [Në linjë]
Available at: <https://www.techfunnel.com/martech/impact-digital-marketing-business/>
8. Barmola, K., 2010. *Research Gate*. [Në linjë]
Available at:
https://www.researchgate.net/publication/333774589_THE_ROLE_OF_CONSUMER_BEHAVIOUR_IN_PRESENT_MARKETING_MANAGEMENT_SCENARIO
[Qasja 2010].
9. Barone, A., 2020. *Investopedia*. [Në linjë]
Available at: <https://www.investopedia.com/terms/d/digital-marketing.asp>
10. Bhardwaj, D., 2019. *CIS*. [Në linjë]
Available at: <https://www.cisin.com/coffee-break/marketing/how-elements-and-process-of-crm-help-in-growing-business.html>
[Qasja 2019].
11. Bizhanova, K. etj., a.d. *Research Gate*. [Në linjë]
[Qasja January 2019].
12. Brockbank, J., 2020. *Semrush*. [Në linjë]
Available at: https://www.semrush.com/blog/what-is-ppc/?kw=&cmp=EE_SRCH_DSA_Blog_Core_BU_EN&label=dsa_pagefeed&Network=g&Device=c&utm_content=484308660186&kwid=dsa-1053501814987&cmpid=11776420745&agpid=113999321666&BU=Core&extid=150557126283&adpos=&gclid=CjwKCAiAsOmABh
[Qasja 2020].
13. Carter, R., 2019. *Sprout Social*. [Në linjë]
Available at: <https://sproutsocial.com/insights/build-customer-relationships/>
[Qasja 2019].
14. Chaffey, D., 2016. *Definitions of E-marketing vs Internet vs Digital Marketing*. [Në linjë]
Available at: <https://www.smartinsights.com/digital-marketing-strategy/online-marketing-mix/definitions-of-emarketing-vs-internet-vs-digital-marketing/>
[Qasja 21 December 2016].
15. Chaffey, D. & Chadwick, F. E., 2016. *Digital Marketing*. Sixth Edition re. s.l.:s.n.

16. Chaffey, D. & Chadwick, F. E., 2019. *Digital Marketing*. Seventh Edition re. s.l.:s.n.
17. Chai, W., 2020. [Në linjë]
Available at: <https://searchcustomerexperience.techtarget.com/definition/CRM-customer-relationship-management>
[Qasja 2020].
18. Cherry, K., 2012. [Në linjë]
Available at: <https://sq.reoveme.com/llojet-e-mostrave-dhe-gabimet-e-marrjes-se-mostrave-ne-hulumtim/>
[Qasja 2012].
19. Claessens, M., 2015. *Marketing Insider*. [Në linjë]
Available at: <https://marketing-insider.eu/new-product-development-process/>
[Qasja 2015].
20. Conductor, a.d. *Conductor*. [Në linjë]
Available at: <https://www.conductor.com/learning-center/content-creation/#:~:text=Content%20creation%20is%20the%20process,and%20then%20actually%20producing%20it.>
21. Consulting, F., 2019. *Sales Force*. [Në linjë]
Available at: <https://www.salesforce.com/crm/what-is-crm/>
22. Daniels, D., 2011. *Pragmatic Institute*. [Në linjë]
Available at: <https://www.pragmaticinstitute.com/resources/articles/product/6-Secrets-of-a-Winning-Product-Launch/>
[Qasja 20 July 2011].
23. Deiss, R. & Henneberry, R., 2007. *Digital Marketing*. s.l.:s.n.
24. Fernando, J., 2020. *Investopedia*. [Në linjë]
Available at: <https://www.investopedia.com/terms/d/distribution-channel.asp#:~:text=A%20distribution%20channel%20represents%20a,sells%20directly%20to%20the%20consumer.>
25. Fifield, P., 2007. *Marketing Strategy*. Third Edition re. s.l.:s.n.
26. Frankenfield, J., 2020. *Investopedia*. [Në linjë]
Available at: <https://www.investopedia.com/terms/s/seo-search-engine-optimization.asp>
27. Galetto, M., 2016. *Ngo Data*. [Në linjë]
Available at: <https://www.ngdata.com/what-is-interactive-marketing/#:~:text=Interactive%20marketing%20is%20a%20one,traditional%20campaign%20based%20marketing%20efforts.>
[Qasja 03 October 2016].
28. Gibbons, M., 2020. *WebFx*. [Në linjë]
Available at: <https://www.webfx.com/blog/marketing/paid-advertising-platforms/>
[Qasja 2020].
29. Gluck, S., 2019. *Chron*. [Në linjë]
Available at: <https://smallbusiness.chron.com/new-product-launch-strategy-3241.html>
30. Goodrich, R., 2020. *Business New Daily*. [Në linjë]
Available at: <https://www.businessnewsdaily.com/5386-location-based-services.html#:~:text=manual%20data%20entry,-,What%20is%20location%20based%20technology%3F,to%20perform%20services%20and%20functions.>
[Qasja 2020].
31. Grech, M., 2019. *Get Voip*. [Në linjë]
Available at: <https://getvoip.com/blog/2019/01/03/call-center-automations/>
32. Hameli, K., 2015. [Në linjë]
Available at: <https://www.slideshare.net/kujtimhameli/llojet-e-mostrave>
[Qasja 2015].

33. Hargrave, M., 2020. *Investopedia*. [Në linjë]
Available at: <https://www.investopedia.com/terms/c/customer-relation-management.asp>
34. Havolli, R., 2019. *Pc World*. [Në linjë]
[Qasja 2019].
35. Hayes, M., a.d. *Shopify Blog*. [Në linjë]
Available at: <https://www.shopify.com/blog/affiliate-marketing>
[Qasja 01 May 2019].
36. Hollar, K., 2015. *Business2Community*. [Në linjë]
Available at: <https://www.business2community.com/customer-experience/whats-difference-traditional-crm-social-crm-cxm-software-01177138#:~:text=Traditional%20CRM%20software%20focuses%20primarily,from%20conferences%20or%20live%20meetings>.
[Qasja 2015].
37. Hoti, A., 2016. [Në linjë]
Available at: https://economics-pr.weebly.com/uploads/4/8/6/0/48608947/metodologjia_hulumtuese_version3.pdf
[Qasja 2016].
38. Hoyos, J., 2011. *Social Media Today*. [Në linjë]
Available at: <https://www.socialmediatoday.com/content/10-steps-integrate-crm-and-social-media-socialcrm-scrm>
[Qasja 2011].
39. Insights, S., a.d. *Smart Insights*. [Në linjë]
Available at: <https://www.smartinsights.com/digital-marketing-strategy/>
40. IPKO, 2019. *IPKO*. [Në linjë]
Available at: <https://www.ipko.com/en/ipko/rreth-ipko/>
[Qasja 2019].
41. Jain, S. C., 1999. *Marketing Planning&Strategy*. Sixth Edition re. s.l.:s.n.
42. Johnson, J., 2017. *Tally Fy*. [Në linjë]
Available at: <https://tallyfy.com/workflow-automation/>
[Qasja 2017].
43. Kagan, J., a.d. *Investopedia*. [Në linjë]
Available at: <https://www.investopedia.com/terms/v/viral-marketing.asp>
[Qasja 19 December 2019].
44. Kanapathy, K., Khong, K. W. & Dekkers, R., 2014. *Hindawi*. [Në linjë]
Available at: <https://www.hindawi.com/journals/jam/2014/542606/#literature-review>
[Qasja 08 January 2014].
45. Karl Ulrich, S. E., 5th Edition. *Product Design and Development*. s.l.:s.n.
46. Kenton, W., 2018. *Investopedia*. [Në linjë]
Available at: [https://www.investopedia.com/terms/s/social-media-marketing-smm.asp#:~:text=Social%20media%20marketing%20\(SMM\)%20is,culture%2C%20mission%2C%20or%20tone](https://www.investopedia.com/terms/s/social-media-marketing-smm.asp#:~:text=Social%20media%20marketing%20(SMM)%20is,culture%2C%20mission%2C%20or%20tone).
[Qasja 4 Februar 2018].
47. Kenton, W., 2019. [Në linjë]
Available at: <https://www.investopedia.com/terms/w/word-of-mouth-marketing.asp>
[Qasja 2019].
48. Kenton, W., 2020. *Investopedia*. [Në linjë]
Available at: <https://www.investopedia.com/terms/m/mobile-marketing.asp>
[Qasja 27 January 2020].
49. Kirtimansharma, 2018. *Kirtimansharma*. [Në linjë]
Available at: <https://www.kirtimansharma.com/blog/what-are-the-steps-for-formulating-digital-marketing-strategy/>
[Qasja 17 November 2018].

50. Kokemuller, N., 2019. *Chron*. [Në linjë]
Available at: <https://smallbusiness.chron.com/early-stages-product-launch-55143.html>
[Qasja 2019].
51. Kotler, P., Armstrong, G., Saunders, J. & Wong, V., 1999. *Principles of Marketing*. Second Edition
re. s.l.:s.n.
52. Kovalenko, I., 2020. *SmartyAds*. [Në linjë]
Available at: <https://smartyads.com/blog/performance-advertising-how-does-it-work/#:~:text=Performance%20based%20advertising%20is%20a,or%20a%20chosen%20specific%20metrics.>
[Qasja 2020].
53. Kozenkow, J., 2019. *Az Central*. [Në linjë]
Available at: <https://yourbusiness.azcentral.com/three-main-objectives-marketing-strategy-7962.html>
[Qasja 2019].
54. LaMarco, N., 2019. *Chron*. [Në linjë]
Available at: <https://smallbusiness.chron.com/role-advertising-media-24611.html>
[Qasja 2019].
55. Linton, I., 2019. *Chron*. [Në linjë]
Available at: <https://smallbusiness.chron.com/new-product-launch-strategy-3241.html>
[Qasja 2019].
56. Luenendonk, M., 2019. *Cleverism*. [Në linjë]
Available at: <https://www.cleverism.com/global-marketing-strategies/>
[Qasja 2019].
57. MacDolnald, S., 2021. *Super Office*. [Në linjë]
Available at: <https://www.superoffice.com/blog/mobile-crm-why-your-organization-needs-it/>
[Qasja 2021].
58. Macy, S., 2020. *Web Fx*. [Në linjë]
Available at: <https://www.webfx.com/blog/marketing/what-is-digital-marketing-strategy/#:~:text=A%20digital%20marketing%20strategy%20describes,online%20marketing%20strategy%20with%20success.>
[Qasja 2020].
59. Mandal, P. & Joshi, N., 2017. Understanding Digital Marketing Strategy. *International Journal of Scientific Research and Management* , 6 June, pp.
https://d1wqtxts1xzle7.cloudfront.net/53578258/11_ijsrm.pdf?1497868551=&response-content-disposition=inline%3B+filename%3DUnderstanding_Digital_Marketing_Strategy.pdf&Expires=1604572926&Signature=YX5KFDV~GYlvzMI~6hZWa2GzrMRP3TDWEwdeHFQOjg3IIPfP5RrhBFd3NR2
.
60. Mehta, V., 2019. *Berkin School of business & innovation*. [Në linjë]
Available at: <https://www.berlinsbi.com/blog/career-advice/the-role-of-strategic-marketing-in-an-organisation/#:~:text=Strategic%20marketing%20is%20a%20method,and%20value%20to%20its%20customers.>
[Qasja 2019].
61. Meyers, S., 2020. *Rolus Tech*. [Në linjë]
Available at: <https://www.rolustech.com/blog/marketing-automation-crm>
[Qasja 2020].
62. Muhamet Hajdari, F. Q. J. F., 2018. *Research Gate*. [Në linjë]
Available at:
https://www.researchgate.net/publication/340398682_IMPACT_OF_FEEDBACK_AND_COMPLAINTS_HANDLING_IN_BANKING_SECTOR
[Qasja 2018].

63. Muhammad, F., 2018. *Insta Page*. [Në linjë]
Available at: <https://instapage.com/blog/display-advertising>
[Qasja 31 August 2018].
64. Owens, J. D., 2000. *Research Gate*. [Në linjë]
Available at:
<https://www.researchgate.net/publication/268272768> The Importance of a New Product Development NPD process Getting Started
[Qasja 2000].
65. Oza, H., 2021. *Prowly*. [Në linjë]
Available at: <https://prowly.com/magazine/advantages-of-digital-marketing-over-traditional-marketing/>
[Qasja 2021].
66. Patel, S., a.d. *Growth Marketing Conference*. [Në linjë]
Available at: <https://growthmarketingconf.com/successful-product-launch/>
67. Point, T., a.d. *Tutorials Point*. [Në linjë]
Available at:
<https://www.tutorialspoint.com/digital-marketing/digital-marketing-web-analytics.htm#:~:text=Web%20Analytics%20is%20the%20measurement,understanding%20and%20optimizing%20Web%20usage.&text=Performance%20measures%20of%20the%20website,the%20site%20meets%20tho>
68. Reshidi, N., 2008. [Në linjë]
Available at:
https://fakultetiekonomik.weebly.com/uploads/2/0/1/3/2013588/menaxhment-marketingu-_ligjerata-te-autorizuara.pdf
[Qasja 2008].
69. Rouse, M., 2020. *Search Customer Experience*. [Në linjë]
Available at: [https://searchcustomerexperience.techtarget.com/definition/CRM-customer-relationship-management#:~:text=Customer%20relationship%20management%20\(CRM\)%20is,retention%20and%20drive%20sales%20growth](https://searchcustomerexperience.techtarget.com/definition/CRM-customer-relationship-management#:~:text=Customer%20relationship%20management%20(CRM)%20is,retention%20and%20drive%20sales%20growth)
70. Ryan, D. & Jones, C., 2009. *Understanding Digital Marketing*. s.l.:s.n.
71. Saez, A., 2019. *Chron*. [Në linjë]
Available at: <https://smallbusiness.chron.com/marketing-strategy-formulation-46179.html>
[Qasja 2019].
72. Samantha, G., 2019. *Chron*. [Në linjë]
Available at: <https://smallbusiness.chron.com/new-product-launch-strategy-3241.html>
73. Schimmel, I., 2015. *Enotes*. [Në linjë]
Available at: <https://www.enotes.com/homework-help/describe-role-played-by-producers-an-economic-176927#:~:text=Producers%20play%20a%20huge%20role%20in%20any%20economic%20system.&text=Producers%20are%20also%20important%20in,and%20services%20from%20various%20producers>
[Qasja 2015].
74. Schneider, D., 2020. *Similar Web*. [Në linjë]
Available at: <https://www.similarweb.com/corp/blog/launching-in-a-new-market/>
[Qasja 07 July 2020].
75. Shanmugam, D. V. & M, L. C., 2017. *UKEssays*. [Në linjë]
Available at: <https://www.ukessays.com/essays/economics/role-service-sector-economic-8066.php#:~:text=Service%20sector%20provides%20finance%2C%20marketing,secondary%20sector%20activities%20as%20well.&text=Service%20sector%20can%20play%20a,of%20income%20in%20the%20econo>
[Qasja 19 October 2017].

76. Shanmugam & Latha, 2017. *Ukessays*. [Në linjë]
Available at: <https://www.ukessays.com/essays/economics/role-service-sector-economic-8066.php>
[Qasja 2017].
77. Silverberg, J. J., 2020. [Në linjë]
Available at: <https://neilpatel.com/blog/google-analytics-to-shape-marketing-strategy/#:~:text=Google%20Analytics%20is%20an%20incredibly,them%20coming%20back%20for%20more.>
[Qasja 2020].
78. Stokes, R., 2010. *E-Marketing*. s.l.:s.n.
79. Storm, M., 2020. *Web FX*. [Në linjë]
Available at: <https://www.webfx.com/blog/marketing/importance-of-digital-marketing/#:~:text=The%20importance%20of%20digital%20marketing%20is%20that%20you%20can%20easily,adapt%20and%20drive%20better%20results.>
[Qasja 07 May 2020].
80. Subramanian, M., 2020. *Campaign India*. [Në linjë]
Available at: <https://www.campaignindia.in/article/opinion-impact-of-digital-marketing-on-consumer-behaviour/457737>
[Qasja 21 January 2020].
81. Sutton, M.-R., 2020. *Shopify Blog*. [Në linjë]
Available at: <https://www.shopify.com/blog/product-development-process>
[Qasja 2020].
82. Taylor, V., 2020. *Business to Community*. [Në linjë]
Available at: <https://www.business2community.com/product-management/how-to-create-a-successful-marketing-strategy-for-a-new-product-launch-02280185>
[Qasja 01 February 2020].
83. Tomita, M., 2019. *Marketo Blog*. [Në linjë]
Available at: [https://blog.marketo.com/2016/02/measure-the-roi-of-digital-advertising-beyond-revenue-impact.html#:~:text=Return%20on%20investment%20\(ROI\)%20is,worth%20from%20your%20marketing%20campaigns.&text=But%20first%2C%20you%20need%20to,the%20ROI%20of%20digital%20](https://blog.marketo.com/2016/02/measure-the-roi-of-digital-advertising-beyond-revenue-impact.html#:~:text=Return%20on%20investment%20(ROI)%20is,worth%20from%20your%20marketing%20campaigns.&text=But%20first%2C%20you%20need%20to,the%20ROI%20of%20digital%20)
[impact.html#:~:text=Return%20on%20investment%20\(ROI\)%20is,worth%20from%20your%20marketing%20campaigns.&text=But%20first%2C%20you%20need%20to,the%20ROI%20of%20digital%20](https://blog.marketo.com/2016/02/measure-the-roi-of-digital-advertising-beyond-revenue-impact.html#:~:text=Return%20on%20investment%20(ROI)%20is,worth%20from%20your%20marketing%20campaigns.&text=But%20first%2C%20you%20need%20to,the%20ROI%20of%20digital%20)
84. Traynor, D., 2019. *Inside Intercom*. [Në linjë]
Available at: <https://www.intercom.com/blog/ways-to-improve-a-product/#:~:text=Product%20improvement%20is%20the%20process,features%20or%20improve%20existing%20ones.>
85. White, L., 2018. *Force Manager*. [Në linjë]
Available at: <https://www.forcemanager.com/blog/sfa-vs-crm-how-to-decide/>
86. Wikipedia, a.d. *Wikipedia*. [Në linjë]
Available at:
https://en.wikipedia.org/wiki/Email_marketing#:~:text=Email%20marketing%20is%20the%20act,or%20solicit%20sales%20or%20donations.
[Qasja January 2015].
87. Writer, R. C., 2020. *Rock Content Blog*. [Në linjë]
Available at: <https://en.rockcontent.com/blog/importance-of-digital-marketing/>
[Qasja 27 February 2020].
88. Yesbeck, J., 2018. *Alexa Blog*. [Në linjë]
Available at: <https://blog.alexa.com/types-of-market-segmentation/>
[Qasja 2019].

Anex

Pyetësor

1) Ku i merni informacionet për produktet ?

- Shoqëria,
- Familja,
- Reklamat,
- Gazetë,
- Të tjera burime

2) A jeni te kënaqur me shërbimet ?

- Shumë të kënaqur,
- Të kënaqur,
- Neutral,
- Të pakënaqur,
- Shumë të pakënaqur

3) Sa gjatë i keni përdorur produktet tona ?

- Më pak se 1 muaj,
- 1-6 muaj,
- 6 muaj-1 vit,
- 1-2 vite,
- 2+ vite

4) Sa shpesh i përdorni produktet tona ?

- Një herë në javë,
- 2-3 herë në muaj,
- 1 herë në muaj,
- cdo 2-3 muaj,
- 1 herë në vit,
- nuk i perdori fare

5) Krahasuar me shërbimet qe i ofrojnë konkurrentët e tjerë, cfarë vlerësimi keni për shërbimet tona ?

Shume i mirë,

Mirë,

Njejtë,

Keq,

Shumë keq

6) A do ti perdorni apo bleni shërbimet e kompanisë Ipko përseri ?

Definitivisht,

Me siguri,

Ndoshta PO ndoshta JO,

Me siguri JO,

Definitiv JO

7) A mbledh informacione për një shërbim/produkt përpara se ta blini ?

PO JO

8) Nese PO, cfarë lloje të informacioneve mlidhni ?

Cmimi,

Kualiteti,

Tiparet,

Kuantiteti,

Eksperienat e klienteve

9) A keni blerë ndonjëherë shërbime online nga ipko ?

PO JO

10) A shikoni programe televizive online ?

PO JO

11) A i lexoni të rejat online ?

PO JO Nganjëherë

12) A keni laptop, tablet apo telefon të menqur ?

PO JO

13) Për çfarë i perdorni këto vegla ?

Lojra,

Shfletim në internet,

Blerje,

Të rejat,

Rrjete sociale,

Lexim Online,

Shikim i Videove,

Chat

14) Kur i përdorni këto vegla?

Përderisa shiqoni TV,

Në zyre,

Në shkollë,

Me shok/shoqe

Në kohë te lirë

Pas orarit te punës/shkollës

15) A i keni vënë re reklamat online të kompanisë gjatë shfletimit?

PO JO Ndonjëherë

16) Nëse po, përmend një nga format e mediave nga lista, ciles i jepni më shumë rëndësi në reklamë?

- TV,
- Online,
- Gazetë,
- Youtube,
- Radio

17) Si e bleni një produkt/shërbim ?

- Hulumtoni në telefon dhe e bleni në pikat shitëse
- Hulumtoni në laptop dhe e bleni në pikat shitëse
- Hulumtoni dhe e bleni përmes telefonit
- Hulumtoni dhe e bleni përmes laptopit
- Vizitoni pikat shitëse

18) Pas blerjes, qfarë lloje eksperiencash i ndani me tjerët?

- Çmime të mira/këqija
- Eksperiencë e keqe me produktet/shërbimet
- Eksperiencë e mirë me produktet/shërbimet
- Të gjitha më lart

19) Si do të ndanit eksperiencat me të tjerët ?

- Në rrjetet sociale
- Mesazhe
- Në websajt të kompanisë
- Përmes të folurit ftyrë për ftyrë

Intervista

1.Si quhet kompania juaj?

Kompania jonë quhet IPKO telekomunikimi.

2.Në cilin vend operon?

Aktualisht operon në tregun e Kosoves, por me ofertat që kemi edhe për në vendet tjera mund të themi se operojmë përtej kufijeve dhe tregjeve të Kosovës.

3. A keni të krijuar departament të marketingut?

Po, departamenti i marketingut është njëri ndër departamentet e krijuara në kompaninë tonë.

4. Nëse keni të krijuar nga kush udhëhiqet?

Departamenti i marketingut udhëhiqet nga Darija Brkic, e cila ka përvojë profesionale të fituar nga vendet e punës ku ka zhvilluar karrieren e saj më herët në disa nga emrat e mëdhenj të telekomit si T-Mobile Croatia dhe VIP/Telekom Austria, që nga viti 2011 Darija udhëheq departamentin e marketingut në kompaninë Ipko.

5. Kush janë konsumatorët e produkteve/sherbimeve tuaja?

Produktet dhe shërbimet tona janë produkte/shërbime të cilat i prekin në përgjithësi të gjitha moshat, shtresat, profesionet dhe të dy gjinitë, duke filluar nga mosha më e re 16 vjecare e deri në moshat më të vjetra, janë shërbimet tona aso soji që të kemi konsumatorë të llojë llojshëm, p.sh janë shërbimet shtëpiake dhe shërbimet biznesore, do të thotë që mund ti prekim të gjitha llojet e konsumatorëve si student/e, nxënës/e, bankier/e, msimëdhënes/e, biznese, amvise etj.

6. A realizoni kërkime të tregut?

Patjetër që realizojmë, zakonisht e kemi një pikënisje të kërkimit, nisemi nga tregu se si është i ndërtuar, mbledhja e të dhënave dhe informacioneve mbi dëshirat dhe kërkesat e konsumatorit, mbledhin informata mbi shërbimet tjera, cmimet, promovimet, cilësia e shërbimeve tona në krahasim me ato të konkurrencës, dizajni i shërbimeve, si do të bëhet lansimi i shërbimit, marketing u që do ta zhvillojmë kur plasojmë shërbime të reja, format e promocioneve që do t'i përdorim, shpenzimet etj

7. Sa i kushtoni rëndësi zhvillimit të produkteve/sherbimeve të reja?

Sherbimet e reja janë si një lloje prezantimi gjithënjë e më i avansuar i kompanisë tonë, andaj kemi shumë kujdes kur kemi të bëjmë përzgjedhjen për zhvillimin e shërbimeve të reja, kështu duke i analizuar të gjithë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm në mënyrë që mos të hasim në vështirësi gjatë zhvillimit të produkteve/shërbimeve.

8. A keni përfituar grante?

Kompania jonë është e vetë financuar dhe nuk kemi përfituar ndonjëherë grante.

9. A keni mbajtur trajnime?

Gjatë gjithë kohës së zhvillimit tonë, ne, po ashtu edhe stafi jonë praktikojmë trajnime të ndryshme, ne lëmi te ndryshme, që ndërlidhen me degët e kompanisë sonë. Se fundmi kemi pasur një trajnim mbi “Psikologjinë e negocimit dhe teknikat e shitjes” ku janë trajnuar një pjesë e stafit tonë.

10. Çka keni përdorur si kriter për segmentimin e tregut?

Duke e parë dendësinë e konsumatorëve, mënyren se si janë të shpërndarë në hapsira në mënyre jo të barabartë, nevojat, kërkesat e ndryshme që kanë, ne përdorim disa kritere në segmentim të tregut: regjionet dhe qytetet ku janë konsumatorët tanë, demografine tyre, moshën, gjininë, të ardhurat, ciklin e jetës, jetën sociale, sjelljet, benefitet, përdorimin feedbackun etj.

11. Preferoni të lansoni produkte cilësore apo me çmime të favorshme?

Zakonisht mundohemi të gjejmë një mes për produktet cilësore dhe cmimet e favorshme, janë dy karakteristika që luaj rol të madh në lansimin e produktit, prandaj me kujdes të vecantë analizojmë cilësinë dhe cmimin e shërbimeve.

12. Nga kush përcaktohet çmimi i produkteve tuaja?

Cmimi përcaktohet nga kosto e produktit/shërbimit, cmimet e konkurrencës, cmimet zëvendësuese, kërkesat e konsumatorëve, vlerësimi i vecorive të produkteve etj.

13. A jeni pjesëmarrës në panaire?

Jemi pjesëmarrës në shumë panaire, më shumë në panaire vendore, por vitin 2020 nuk kemi pasur mundësi të jemi pjesë e panaireve shkakut i mosorganizimit të tyre dhe i gjendjes pandemike.

14. Sa shpesh përdorni kampanja?

Cdo vit organizojmë kampanja për imazhin e Ipko-s.

15. A realizoni kampanja me informacion shtesë për produktet?

Po, gjithmone që është e nevojshme.

16. A e shpërbleni konsumatorin besnik?

Të gjithë konsumatorët tanë shpërblehen, gjithmone në ditëlindjet e tyre shpërblehen me Pikë nga ofertat tona, ku nga mbledhja e atyre pikëve mund të marin dhurata të ndryshme varësisht nga pikët e grumbulluara,po ashtu edhe konsumatorët besnik.

17. Cilin lloj të promocionit preferoni për të promovuar produktet/shërbimet tuaja?

Përdorim disa lloje të promocioneve si reklama, publiciteti, shitja personale etj me te cilat promocione në informojmë qe të ngritet vetëdija e konsumatoreve mbi shërbimet tona, spjegohet për përdorimin e shërbimeve, ndërtmin e imazhit të kompanisë, promocione kujtese për të përkujtuar konsumatorin se i nevojitet ende shërbimi, për të përkujtuar konsumatorin se ku mund të blejë produktin/shërbimin, promocione bindëse për të ndërruar perceptimin e konsumatorit mbi produktin/shërbimin dhe të influencojmë në vendim për blerje të produktit/shërbimit.

18.Sa ka efekt marketing digjital ne plasimin e produkteve te reja?

Efekti i marketingut digjital mund të vërehet në shitjet që realizon kompania, ka ndikim te madh sidomos gjatë plasimit të produkteve/shërbimeve të reja në treg, është një dorë shtytëse në kompaninë tonë dhe ndihmon në zhvillimin e sigurtë të produkteve/shërbimeve. IPKO është fitues i çmimeve Best Buy dhe Customers' Friend në të gjitha kategoritë e shërbimeve 2019/ 2021, dhe në këtë ka ndikim te madh marketingu digjital.

19.A e reklamoni qdo product/shërbim te juajin ne tv dhe rrjete sociale ?

PO, gjithmonë cdo produkt dhe shërbim e reklamojmë në tv dhe rrjete sociale

20.Sa shpesh sillni shërbime ne treg ?

2 herë ne vit.